

B A N K A E S H Q I P Ë R I S Ë

B U L E T I N I Z Y R T A R

V Ë L L I M I 7, N U M R I 14, N Ë N T O R 2005

Data e botimit 16.11.2005

P Ë R M B A J T J A

1.	Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 79, datë 31.10.2005 "Për caktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë"	5
2.	Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 80, datë 01.11.2005 "Për miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2005"	33
3.	Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 83, datë 01.11.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit Juridik të Bankës së Shqipërisë"	69
4.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 1, Shkurt 2005	70
5.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 2, Shkurt 2005	70
6.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 3, Shkurt 2005	70
7.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 4, Prill 2005	70
8.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 5, Prill 2005	70
9.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 6, Maj 2005	71
10.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 7, Maj 2005	71
11.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 8, Qershor 2005	71
12.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 9, Qershor 2005	71
13.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 10, Korrik 2005	72
14.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 11, Gusht 2005	72
15.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 12, Shtator 2005	72
16.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 13, Tetor 2005	72



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

NR. 79, DATË 31.10.2005

**PËR
PËR CAKTIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE DHE NUMRIN E
PUNONJËSVE NË ORGANIKË TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Juridik, në bazë të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe Statutit të Bankës së Shqipërisë", neni 43, shkronja "gj",

V E N D O S I :

1. Të miratojë strukturën organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë, sipas pasqyrave bashkëlidhur.
2. Të miratojë numrin e punonjësve në organikë gjithsej në Bankën e Shqipërisë 416 (katërqindegjashtëmbëdhjetë), nga të cilët 334 (treqindetridhjetekatër) punonjës për administratën qendrore, 22 (njëzetedy) punonjës për Shtypshkronjën dhe 60 (gjashtëdhjetë) punonjës për degët e Bankës së Shqipërisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe të gjitha njësitë e tjera organizative të Bankës së Shqipërisë, të marrin masat e duhura për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe i Komunikimit me publikimin e këtij vendimi.
5. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 25, datë 01.04.2003 "Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të punonjësve të Bankës së Shqipërisë", si dhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës nr. 104, datë 10.12.2003 dhe nr. 33, datë 27.04.2005 "Për disa ndryshime në vendimin nr.25, datë 01.04.2003 "Për miratimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003" shfuqizohen.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI
YLLI MEMISHA**

**KRYETARI
ARDIAN FULLANI**

NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKËN E BANKËS SË SHQIPËRISË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79 DATË 31.10.2005.)

NR.	EMËRTIMI I VENDEVE TË PUNËS NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE	NR. I PUNONJËSVE
1.	ADMINISTRATA GENDRORE	334
2.	ADMINISTRATA LOKALE DHE SHTYPSHKRONJA	82
	GJITHSEJ	416

1. NUMRI I PUNONJËSVE DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE NË ORGANIKËN E ADMINISTRATËS QENDRORE

NR.	EMËRTIMI I VENDEVE TË PUNËS NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE	NR. I PUNONJËSVE
1.	GUVERNATOR	1
2.	ZËVENDËSGUVERNATOR I PARË	1
3.	ZËVENDËSGUVERNATOR I DYTË	1
4.	INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM	1
5.	KABINETI I GUVERNATORIT	11
6.	ZYRAT E ADMINISTRATORËVE	6
7.	DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE	11
8.	DEPARTAMENTI I POLITIKAVE MONETARE	18
9.	DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE	16
10.	DEPARTAMENTI I OPERACIONEVE MONETARE	24
11.	DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES	35
12.	DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	24
13.	DEPARTAMENTI I STATISTIKËS	19
14.	DEPARTAMENTI I EMISIONIT	34
15.	DEPARTAMENTI I KONTABILITETIT DHE PAGESAVE	26
16.	DEPARTAMENTI JURIDIK	5
17.	DEPARTAMENTI I KONTROLLIT	6
18.	DEPARTAMENTI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË, INTEGRIMIT EUROPIAN DHE I KOMUNIKIMIT	19
20.	DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT	50
19.	DEPARTAMENTI I SIGURIMIT DHE I MBROJTJES	26
	TOTALI	334

2. NUMRI I PUNONJËSVE DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE NË ORGANIKËN E ADMINISTRATËS LOKALE DHE TË SHTYPSHKRONJËS

NR.	EMËRTIMI I VENDEVE TË PUNËS NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE	NR. I PUNONJËSVE
1	DEGA E BANKËS SË SHQIPËRISË NË SHKODËR	12
2	DEGA E BANKËS SË SHQIPËRISË NË ELIBASAN	12
3	DEGA E BANKËS SË SHQIPËRISË NË LUSHNJË	12
4	DEGA E BANKËS SË SHQIPËRISË NË KORÇË	12
5	DEGA E BANKËS SË SHQIPËRISË NË GJIROKASTËR	12
6	SHTYPSHKRONJA E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TIRANË	22
	Gjithsej	82

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

I.KABINETI I GUVERNATORIT

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërlimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
1.	Shef i Kabinetit të Guvernatorit	1
2.	Këshilltar	4
3.	Sekretar i Këshillit Mbikëqyrës	1
4.	Kryesekretar	1
5.	Asistent për Marrëdhëniet me Jashtë	1
6.	Sekretar	1
7.	Shofer	2
	Gjithsej	11

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

ZYRAT E ADMINISTRATORËVE TË TJERË

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

II. ZYRA E ZËVENDËSGUVERNATORIT TË PARË

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
1.	Sekretare	1
2.	Shofer pranë Zëvendësguvernatorit të Parë	1
	Gjithsej (zyra e Zëvendësguvernatorit të Parë)	2

III. ZYRA E ZËVENDËSGUVERNATORIT TË DYTË

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
1.	Kryetar i Komisionit të Prokurimit	1
2.	Sekretare	1
3.	Shofer pranë Zëvendësguvernatorit të Dytë	1
	Gjithsej (Zyra e Zëvendësguvernatorit të Dytë)	3

IV. ZYRA E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
1.	Shofer pranë Inspektorit të Përgjithshëm	1

GJITHSEJ (ZYRAT E ADMINISTRATORËVE TË TJERË)	6
---	----------

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

V. DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor Departamenti	1
A.	Sektori Politikave të Burimeve Njerëzore	3
I.	Zëvendës drejtor dhe Përgjegjës i Sektorit të Politikave	1
2.	Specialistë	2
B.	Sektori i Procedurave Administrative	7
I.	Përgjegjës Sektori	1
II.	Zyra e Procedurave Administrative	3
2.	Specialistë	2
3.	Operator	1
III.	Zyra e Arshiv - Protokollit	3
3.	Arkiviste/Protokolliste	3
	Gjithsej	11

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

VI. DEPARTAMENTI I POLITIKAVE MONETARE

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor Departamenti	1
A.	Sektori Financiar	10
I.	Zevëndësdirjtor dhe Përgjegjës Sektori	1
II.	Zyra e Çështjeve Monetare	5
1.	Përgjegjës Zyra	1
2.	Specialistë	4
III.	Zyra e Tregjeve	4
1.	Përgjegjës Zyra	1
2.	Specialistë	3
B.	Sektori i Ekonomisë	7
I.	Përgjegjës Sektori	1
2.	Specialistë	6
	Gjithsej	18

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

VII. DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NE ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor Departamenti	1
A.	Spektori i Kërkimeve Ekonomike	8
1.	Zëvendës drejtor dhe Përgjegjës Spektori	1
2.	Specialistë	7
B.	Spektori i Modelimit Makroekonomik	7
11.	Përgjegjës Spektori	1
2.	Specialistë	6
	Gjithsej	16

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

VIII. DEPARTAMENTI I OPERACIONEVE MONETARE

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor Departamenti	1
A.	Sektori i Operacioneve	8
1.	Zëvendësdrejtor dhe Përgjegjës Sektori	1
2.	Specialist për Operacionet me Valutë	4
2.	Specialist për Operacionet me Lekë	2
3.	Operator	1
B.	Sektori i Marrëdhënieve me Qeverinë dhe Borxhit të Jashtëm	12
1.	Zëvendësdrejtor dhe Përgjegjës Sektori	1
2.	Specialistë	5
II.	Zyra e Borxhit të Jashtëm	2
2.	Specialistë	2
III.	Zyra e Bonove të Theasrit	4
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Specialistë	1
3.	Arkëtare	2
C.	Zyra e "Middle Office"	3
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Specialistë	1
3.	Specialist për rrezikun e institucionit	1
	Gjithsej	24

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

IX. DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor Departamenti	1
A.	Spektori i Analizës dhe Inspektiveve	26
I.	Zëvendësdirjtor dhe Përgjegjës Spektori	1
II.	Zyra e Analizës	4
1.	Përgjegjës Zyra	1
2.	Specialistë	3
III.	Zyra e Inspektiveve	21
1.	Përgjegjës Zyra	1
2.	Specialistë	20
B.	Spektori i Licencimit, Rregullimit dhe Standardeve	8
I.	Zëvendësdirjtor dhe Përgjegjës Spektori	1
II.	Zyra e Licencimit	2
2.	Specialistë	2
III.	Zyra e Rregullimit, Interpretimit dhe e Standardeve	3
1.	Përgjegjës Zyra	1
2.	Specialistë	2
IV.	Zyra e Kërimit dhe e Konsistencës	2
2.	Specialistë	2
	Gjithsej	35

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë njihen në fuqi me datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

X. DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË
(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor Departamenti	1
A.	Spektori i Administrimit të Teknologjisë	9
1.	Përgjegjës Spektori	1
2.	Specialistë	4
2.	Specialist Help - Desk	2
II.	Zyra e Administrimit të Sigurisë	2
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Oficerë Sigurie	1
B.	Spektori i Suportit të Aplikimeve Bankare	13
1.	Zëvendës drejtor dhe Përgjegjës Spektori	1
II.	Zyra e Administrimit të Sistemeve të Pagesave	6
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Specialistë	5
III.	Zyra e Administrimit të Sistemeve të Brendshme	4
2.	Specialistë	4
IV.	Zyra e Programimit	2
1.	Përgjegjës Zyre	0
2.	Specialistë	2
C.	Administrator Projektsh	1
	Gjithsej	24

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

XI. DEPARTAMENTI I STATISTIKËS

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor Departamenti	1
A.	Spektori i Bilancit të Pagesave	8
I.	Zëvendësdrejtor dhe Përgjegjës Spektori	1
II.	Zyra e Bilancit të Pagesave	4
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Specialistë	3
III.	Zyra e Vrojtimeve	3
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Specialistë	2
B.	Spektori i Statistikave Financiare	10
I.	Përgjegjës Spektori	1
II.	Zyra e Statistikave Monetare dhe Financiare	5
2.	Specialistë	3
3.	Operatorë	2
III.	Zyra e Administrimit të Raportimeve	4
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Specialistë	2
3.	Operatorë	1
	Gjithsej	19

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

XII. DEPARTAMENTI I EMISIONIT

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor Departamenti	1
A.	Sektori i Emisionit dhe i Administrimit të Parasë	5
1.	Zëvendësdrejtor Departamenti dhe Përgjegjës i Sektorit	1
2.	Specialistë	3
3.	Shoqërues fondesh me arsim të mesëm	1
B.	Zyra e Arkës Stok	4
1.	Përgjegjës Zyre	1
3.	Punonjës me arsim të mesëm	3
C.	Zyra e Prodhimit dhe e Përpunimit të Monedhës Metalike	4
1.	Përgjegjës Zyre	1
3.	Përpunues Fondesh	3
D.	Sektori i Arkës për Veprim dhe i Përpunimit të Fondëve	19
I.	Përgjegjës Sektori	1
II.	Zyra e Arkës për Veprim	4
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Specialist me arsim të mesëm	3
III.	Zyra e Përpunimit të Fondëve	14
1.	Përgjegjës Zyre	1
3.	Specialist me arsim të mesëm	13
E.	Kontrollor/Mbikëqyrës	1
	Gjithsej	34

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

XIII. DEPARTAMENTI I KONTABILITETIT DHE I PAGESAVE
STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË
(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor Departamenti	1
A	Sektori i Kontabilitetit	6
I.	Përgjegjës Sektori	1
II.	Zyra e Kontrollit	3
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Specialistë	2
III.	Zyra e Analizës dhe Raportimeve	2
2.	Specialistë	2
B	Sektori i Financës	8
I.	Përgjegjës Sektori	1
1.	Specialistë	5
II.	Zyra e Buxhetit	2
2.	Specialistë	2
C	Sektori i Sistemeve të Pagesave	11
I.	Përgjegjës Sektori dhe Zëvendësdrejtor i Departamentit	1
II.	Zyra e Shlyerjeve (AIPS)	3
2.	Specialistë	3
III.	Zyra e Kleringut (AECH etj.)	2
2.	Specialistë	2
IV.	Zyra e Politikave dhe Mbrojtjes së Sistemit të Pagesave	2
2.	Specialistë	2
V.	Zyra e Back-Office	3
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Specialist për operacionet në Lek/Valutë	2
	Gjithsej	26

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbrojtës

XIV. DEPARTAMENTI I JURIDIK

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor Departamenti	1
A.	Zyra e Hartimit Ligjor	3
1.	Përgjegjës Zyra	1
2.	Specialistë/Juristë	2
B.	Zyra e Çështjeve Juridike	1
2.	Specialistë/ Juristë	1
	Gjilhsej	5

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

XV. DEPARTAMENTI I KONTROLLIT

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
1.	Inspektorë të kontrollit	5
2.	Inspektor i teknologjisë së informacionit	1
	Gjithsej	6

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

**XVI. DEPARTAMENTI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË, INTEGRIMIT
EVROPIAN DHE I KOMUNIKIMIT**

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor Departamenti	1
A.	Sektori i Botimeve	9
1.	Përgjegjës Sektori	1
2.	Specialistë	8
	(Design&layout)	(1)
	(Marrëdhënie me publikun)	(2)
	(Përkthyes)	(4)
	(Specialist Bibliotekë)	(1)
B.	Zyra e Qendrës së Shtypit	3
2.	Specialistë	3
	(Kordinator për Web-Site)	(1)
	(Kontaktet me Median)	(1)
	(Zëdhënës Shtypi)	(1)
C.	Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integrimit Evropian	4
1.	Përgjegjës Sektori	1
2.	Specialistë	3
	(për Integrimin Evropian)	(1)
	(për marrëdhëniet me Bankat Evropiane)	(1)
	(për marrëdhëniet me FMN, BB)	(1)
D.	Sekretariat (në nivel zyre)	2
2.	Specialistë	2
	(Shërbimi Protokoliar)	(1)
	(Sekretar)	(1)
	Gjithsej	19

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

XVII. DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor Departamenti	1
A.	Spektori Teknik dhe i Shërbimeve	27
I.	Zëvendësdrjtor dhe Përgjegjës Sektori	1
II.	Zyra e Projektimit dhe e Investimeve	3
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Specialistë	2
III.	Zyra e Mirëmbajtjes dhe Shërbimeve	23
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Specialistë me arsim të lartë	2
3.	Punonjës me arsim të mesëm	20
	(elektricit)	(1)
	(elektricit,nderlidhje)	(1)
	(hidraulik,saldator)	(1)
	(balaxhi)	(1)
	(marangaz,murator)	(1)
	(fotokopje)	(2)
	(swift)	(1)
	(te/eks)	(1)
	(central)	(1)
	(posta e Bankës)	(1)
	(magaziniër)	(2)
	(postues)	(7)
B.	Njësia e Parkut (në nivel zyre)	15
1.	Përgjegjës i Parkut	1
3.	Punonjës me arsim të mesëm	14
	(mekanik)	(1)
	(elektroat)	(1)
	(shofer i automjeteve të blinduara)	(4)
	(shoferë të administratës)	(7)
	(lavazhier dhe postues)	(1)
C.	Spektori i Prokurimeve	7
I.	Përgjegjës Sektori	1
2.	Specialistë	6

	<i>(jurist)</i>	<i>(1)</i>
	<i>(ekonomist i prokurimeve)</i>	<i>(1)</i>
	<i>(ekonomist për studimin e tregut)</i>	<i>(1)</i>
	<i>(ekonomist për blerjet e vogla)</i>	<i>(3)</i>
	Gjithsej	50

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

XVIII. DEPARTAMENTI I SIGURIMIT DHE I MBROJTJES

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor Departamenti	1
A.	Spektori i Sigurimit	12
	Zevendesdrejtor dhe Përgjegjës Sektori	1
I.	Zyra e Sigurimit të Brendshëm	11
2.	Specialistë për Sigurimin e Brendshëm	3
3.	Nëpunës roje	8
I.	Zyra e Koordinimit	3
2.	Specialistë	2
	<i>(Specialistë për koordinimin, për kartëmonedhat e falsifikuara dhe MKZ)</i>	(1)
	<i>(Specialistë për mbrojtjen elektronike)</i>	(1)
3.	Inspektorë Sigurimi	1
	<i>(Inspektor i Sigurimit dhe i Mbrojtjes në Berat)</i>	(1)
III.	Zyra e Qendrave Operative	10
1.	Përgjegjës Zyre	1
3.	Punonjës me arsim të mesëm	9
	<i>(Vëzhgues në dy qendra operative)</i>	(8)
	<i>(Teknik i mirëmbajtjes së sistemeve elektronike të sigurimit)</i>	(1)
	Gjithsej	26

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

**XIX. DEGET E BANKËS SË SHQIPËRISË
STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË**

1. DEGA E BANKËS SË SHQIPËRISË SHKODËR

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor	1
2.	Specialistë	2
A.	Spektori i Përpunimit të Fondëve	9
1.	Përgjegjës Spektori	1
3.	Arkëtar	1
	Përpunues fondesh	4
II.	Zyra Mbeshtetëse	3
3.	Shofer dhe teknik mirëmbajtës	1
	Punëtor pastrimi, korrier	1
	Inspektor i sigurimit dhe i mbrojtjes	1
	Gjithsej	12

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

2. DEGA E BANKËS SË SHQIPËRISË ELBASAN

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor	1
2.	Specialistë	2
A.	Spektori i Përpunimit të Fondëve	9
1.	Përgjegjës Sektori	1
3.	Arkëtar	1
	Përpunues fondesh	4
II.	Zyra Mbeshtetëse	3
3.	Shofer dhe teknik mirëmbajtës	1
	Punëtor pastrimi, karrier	1
	Inspektor i sigurimit dhe i mbrojtjes	1
	Gjithsej	12

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

3. DEGA E BANKËS SË SHQIPËRISË LUSHNJE

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor	1
2.	Specialistë	2
A.	Spektori i Përpunimit të Fondëve	9
1.	Përgjegjës Spektori	1
3.	Arkëtar	1
	Përpunues fondesh	4
II.	Zyra Mbështetëse	3
3.	Shofer dhe teknik mirëmbajtës	1
	Funëtar pastrimi, korrier	1
	Inspektor i sigurimit dhe i mbrojtjes	1
	Gjithësej	12

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

4. DEGA E BANKËS SË SHQIPËRISË KORÇË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor	1
2.	Specialistë	2
A.	Spektori i Përpunimit të Fondëve	9
1.	Përgjegjës Sektori	1
3.	Arkëtar	1
	Përpunues fondesh	4
II.	Zyra Mbeshtetëse	3
3.	Shofer dhe teknik mirëmbajtës	1
	Punëtor pastrimi, karrier	1
	Inspektor i sigurimit dhe i mbrojtjes	1
	Gjithsej	12

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

5. DEGA E BANKËS SË SHQIPËRISË GJIROKASTËR

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor	1
2.	Specialistë	2
A.	Spektori i Përpunimit të Fondëve	9
1.	Përgjegjës Sektori	1
3.	Arkëtar	1
	Përpunues fondesh	4
II.	Zyra Mbeshtetëse	3
3.	Shofer dhe teknik mirëmbajtës	1
	Punëtor pastrimi, karrier	1
	Inspektor i sigurimit dhe i mbrojtjes	1
	Gjithsej	12

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

XX. SHTYPSHKRONJA E BANKËS SË SHQIPËRISË

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 79, DATË 31.10.2005.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor i Shtypshkronjës	1
A.	Dega Ekonomike	5
1.	Kryetar i Degës Ekonomike	1
3.	Punonjës me arsim të mesëm	
	<i>(Fumizim-Transport)</i>	1
	<i>(Magaziner-Najekës normativash)</i>	1
	<i>(Shofer)</i>	1
	<i>(Punëtorë pastrimi)</i>	1
B.	Spektori i Shtypit	16
1.	Përgjegjës Spektori	1
3.	Punonjës me arsim të mesëm	15
	<i>(Procedurë-cilës-arkëtorë)</i>	(1)
	<i>(Mekanik Kolaudator-Mirëmbajtës)</i>	(1)
	<i>(Parapërgatitje Shtypi)</i>	(1)
	<i>(Makinist shtypi offset, Shtypi i lartë me numrator dhe Makinist shtypi linja me traktor)</i>	(3)
	<i>Ndihmës makinist shtypi offset, i lartë dhe me traktor</i>	(3)
	<i>(Makinist thike, Makinist palosje, Makinist tranxhi me shtyp, Makinist biosje, Makinist futkallasje, Kolaudator prodhimi dhe Lidhje speciale)</i>	(3)
	<i>(Punime të ndryshme libërlihdje)</i>	(3)
	Gjithsej	22

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi më datë 01.11.2005.

Ardian Fullani
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

NR.80, DATË 01.11.2005

PËR MIRATIMIN E OPINIONIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË
"MBI GJENDJEN E EKONOMISË GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT
2005"

Në mbështetje të nenit 43, shkronja "ç" dhe të nenit 69, pika 5 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Të miratojë opinionin e Bankës së Shqipërisë **"Mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2005"**, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare me dërgimin e këtij materiali në Kuvendin e Shqipërisë, në Presidencë, në Këshillin e Ministrave dhe në Ministrinë e Financave.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe i Komunikimit me publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
YLLI MEMISHA

KRYETARI
ARDIAN FULLANI

BANKA E SHQIPËRISË

OPINION
MBI GJENDJEN E EKONOMISË
GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2005

NËNTOR 2005

I. FJALA E GUVERNATORIT

Nëntë muajt e parë të vitit 2005 kanë paraqitur një tablo pozitive në drejtim të rritjes ekonomike dhe të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik. Aktiviteti ekonomik ka lëvizur përgjithësisht brenda trajektores së parashikuar nga programi i zhvillimit të vendit. Ky vlerësim mbështetet në një sërë treguesish si: rritja e dukshme e vëllimit të shitjeve; rritja e të ardhurave tatimore; zgjerimi i eksporteve; ulja e normës së papunësisë dhe zgjerimi i punësimit. Një zhvillim i spikatur i vitit 2005, i cili ka dhënë kontributin e tij në rritjen e aktivitetit ekonomik, është mbështetja më e mirë e ekonomisë me kredi nga sistemi bankar. Pjesa më e madhe e këtij kreditimi ka shkuar për financimin e aktiviteteve prodhuese dhe të tregtisë. Ekonomia është favorizuar edhe nga politika monetare neutrale e Bankës së Shqipërisë, e cila ka kontribuar në ruajtjen e normave të interesit në nivele të ulëta historike.

Duke u bazuar në të dhënat që kemi në dispozicion, Banka e Shqipërisë vlerëson se ekonomia ka shenja të dukshme rritjeje gjatë nëntëmuajorit të parë. Në veçanti, aktiviteti ekonomik ka patur një hop të dukshëm gjatë tremujorit të dytë, duke treguar gjallërim të prodhimit në të gjithë sektorët e ekonomisë. Në vijim të dinamikave tashmë të konsoliduara të ekonomisë shqiptare, zgjerimi i prodhimit është mbështetur kryesisht në sektorët “Energji elektrike, ujë dhe gaz”, “Transport dhe telekomunikacion” dhe “Ndërtim”. Në fund të muajit qershor, norma e papunësisë arriti vlerën 14.3 për qind, duke shënuar një ulje prej 0.5 pikësh përqindjeje ndaj një viti më parë. Sipas INSTAT, në harkun kohor të një viti ekonomia shqiptare ka krijuar 13.4 mijë vende të reja pune në sektorin privat, i cili vazhdon të mbetet motorri i rritjes ekonomike.

Bilanci i pagesave ka paraqitur një rezultat pozitiv prej 11 milionë eurosh deri në muajin qershor. Hyrjet e kapitalit kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar deficitin korent, i cili arriti në rreth 145 milionë euro, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit. Deficiti në tregtinë e mallrave dhe të shërbimeve ka qenë burimi kryesor i deficitit korent. Llogaria kapitale dhe financiare ka regjistruar hyrje neto prej rreth 197 milionë eurosh, ndërkohë që rezervat valutore të autoritetit monetar janë rritur me rreth 7 milionë euro gjatë kësaj periudhe. Ashtu si dhe më parë, deficiti i lartë tregtar financohet në pjesën më të madhe nga hyrjet korente në formën e të ardhurave nga emigrantët, si edhe nga hyrjet kapitale dhe financiare në formë grantesh, borxhi qeveritar dhe privat, dhe investimet direkte.

Rritja ekonomike është favorizuar nga ambienti i qëndrueshëm makroekonomik, i shprehur në inflacion të ulët, respektim të vlerave të programuara të deficitit buxhetor dhe një situatë monetare nën kontroll. Inflacioni vjetor në fund të muajit shtator arriti në 3.1 për qind, praktikisht pika e mesit të objektivit të Bankës së Shqipërisë, ndërsa inflacioni mesatar vjetor është luhatur rreth kufirit të poshtëm të këtij objekti. Në përgjigje të zhvillimeve ekonomike dhe monetare, presionet dhe pritjet inflacioniste mbeten nën kontroll edhe për periudhën e ardhme. Norma e inflacionit gjatë tremujorit të tretë është kushtëzuar nga kontributi i grupeve “Ushqime dhe pije joalkolike” e “Transport”. Tremujori i tretë i vitit u karakterizua nga rritja e ndjeshme e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare, duke përbërë një sfidë reale ndaj aktivitetit ekonomik në nivel botëror. Megjithatë, e amortizuar nga mbiçmimi i kursit të këmbimit, rritja e çmimeve në tregun vendas ka qenë pothuaj dy herë më e ulët. Peshë e ulët e karburanteve në shportën e mallrave të konsumit në

Shqipëri, ka bërë që ndikimi i saj në inflacion të jetë i vogël ndërsa nuk vihet re ende rritje e kostove të produkteve si pasojë e rritjes së çmimit të karburanteve.

Konsolidimi i stabilitetit makroekonomik ka ndihmuar kontrollin e presioneve inflacioniste. Treguesit kryesorë të programit buxhetor janë respektuar në tërësinë e tyre. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, deri në fund të muajit shtator, janë mbledhur 97.5 për qind e të ardhurave të planifikuara dhe është realizuar rreth 96.4 për qind e shpenzimeve të programuara. Po kështu, deficitit buxhetor dhe financimi i brendshëm i tij, kanë qenë përgjithësisht brenda parashikimit. Gjithsesi, gjatë tremujorit të tretë, si pasojë e një procesi të gjatë paselektoral, u vu re një ngadalësim i fluksit të të ardhurave, ndërkohë që nga ana tjetër, kjo periudhë është shoqëruar me përqendrimin e huamarrjes së qeverisë e cila, ndonëse ka respektuar kufijtë vjetorë, ka krijuar vështirësi në administrimin e situatës së likuiditetit. Banka e Shqipërisë vlerëson se forcimi i administrimit fiskal si dhe respektimi i kriterëve të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik, duhet të mbeten një përparësi konstante e politikës fiskale.

Zhvillimet makroekonomike dhe qëndrueshmëria e inflacionit në nivele të ulta janë favorizuar edhe nga situata monetare. Pas uljes së fundit të normës bazë të interesit në muajin mars, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare neutrale. Gjatë tremujorit të tretë është vënë re një ngadalësim i ritmit të rritjes së ofertës monetare, përkundrajt rritjes së shpejtë të saj në gjysmën e parë të vitit. Norma e rritjes vjetore të agregatit M3 në muajin gusht, zbriti në 15.4 për qind, nga 18.3 për qind që ishte në fund të muajit qershor. Nën ndikimin e ngushtimit të diferencës së normave të interesit midis lekut dhe valutës, dhe rritjes sezonale të hyrjeve valutore në formën e remitancave, struktura e ofertës monetare është zhvendosur drejt depozitave në valutë, ndërkohë që struktura kohore ka rezultuar relativisht e qëndrueshme. Ecuria e mjeteve valutore neto të sistemit bankar në muajin gusht paraqitet e kënaqshme, me një rritje prej 112.7 milionë usd krahasuar me muajin qershor. Deri në muajin gusht, teprica e kredisë është rritur me rreth 31 miliardë lekë; rritje kjo rreth 60 për qind më e lartë se rritja e tepricës së kredisë për gjithë vitin 2004. Aktiviteti i vullshëm i kreditimit është shoqëruar me përmirësimin e të gjithë treguesve të kredisë; raporti i saj ndaj parasë gjithsej ka arritur në nivelin 18 për qind, ndërkohë që pesha e kredisë në PBB ka kapur vlerën 11.8 për qind.

Rritja e kredisë për ekonominë, financimi i përqendruar i deficitit buxhetor dhe ngadalësimi i fluksit të depozitave, kanë sjellë rënien e likuiditetit të sistemit bankar gjatë tremujorit të tretë, duke kontribuar në rritjen e presioneve mbi *yield*-in e bonove të thesarit. Në kushtet e një tregu bankar të privatizuar dhe një tregu relativisht të pazhvilluar të bonove të thesarit, *yield*-i i bonove të thesarit pësoi një rritje, e cila nuk ka qenë në përputhje me situatën dhe me faktorët bazë makroekonomikë. Për administrimin e kësaj shtate, Banka e Shqipërisë vlerësoi me kujdes kuadrin e saj operacional si dhe pozicionin e parashikuar të saj në tregun valutë, duke synuar ruajtjen e ekuilibrave monetarë. Gjatë muajit korrik, Banka e Shqipërisë ndryshoi kahun e operacioneve monetare, me qëllim plotësimin e nevojave afatshkurtra të sistemit për likuiditet, nëpërmjet kryerjes së repove të anasjellta.

Plotësimi i nevojave të përkoshme të tregut me likuiditet si dhe financimi i deficitit buxhetor nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet kredive direkte afatshkurtra për qeverinë, kishin si qëllim zbutjen e presionit mbi normat e interesit të bonove të thesarit, me theks të veçantë

në frenimin e rritjes së tyre. Ndërkohë, gjysma e dytë e muajit tetor është shoqëruar me normalizim të situatës dhe ulje të *yield*-it të bonove të thesarit. Si pasojë e ngushtimit të diferencës së normave të interesit gjatë këtij viti, prurjet valutore të emigrantëve kanë gjetur rrugën në sistemin bankar, kryesisht në formën e depozitave në valutë. Në prani të një regjimi fleksibël të kursit të këmbimit, kjo dukuri ka kufizuar hapësirat për praninë sezonale të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor. Aktiviteti karakteristik i Bankës së Shqipërisë në tregun valutor në fund të verës, ka qenë i kufizuar këtë vit. Këta faktorë kanë çuar në shmangien e përkohshme të disa treguesve monetarë nga vlerat e parashikuara. Duke përgjithësuar zhvillimet monetare të verës së vitit 2005, mund të konkludohet se administrimi i situatës monetare nga Banka e Shqipërisë ka qenë i efekshëm dhe kjo vërtetohet nga përmirësimi i situatës së likuiditetit të sistemit në muajt shtator-tetor dhe zbutja e presioneve mbi normat e interesit.


Megjithë zhvillimet përgjithësisht pozitive të nëntëmuajorit të parë, ekonomia shqiptare ka përpara saj disa sfida të karakterit strukturor, zgjidhja e të cilave do të përbënte një kontribut të ndjeshëm në konsolidimin e ritmeve të rritjes ekonomike. Situata e rënduar energjitike përbën një problem konstant për ekonominë shqiptare. Intensiteti i kësaj krize dhe ndjeshmëria e bizneseve shqiptare ndaj saj, mund të kushtëzojnë edhe realizimin e objektivit të rritjes ekonomike prej 6 për qind për vitin 2005. Situata bëhet më problematike në prani të shtrenjtimit të çmimit të karburanteve dhe të shtrenjtimit të çmimit të energjisë në rajon. Kombinimi i këtyre faktorëve mund të përbëjë një rrezik, i cili mund ta shtrijë ndikimin e vet edhe në vitin e ardhshëm.

Në këtë kontekst, duke hedhur vështrimin në të ardhmen, Banka e Shqipërisë vlerëson se duhet punuar për zgjidhje të qëndrueshme të këtij problemi, për të minimizuar në maksimum varësinë e ekonomisë sonë ndaj faktorëve subjektivë përfshirë edhe kushtet atmosferike. Përmirësimi i klimës së biznesit në vend kërkon, ndër të tjera, zbatimin e projekteve që lidhen me shtimin e burimeve alternative energjitike në vend.

II. ZHVILLIMET EKONOMIKE DHE INFLACIONI


II.1 ECURIA E EKONOMISË SHQIPTARE

Ekonomia shqiptare ka shfaqur një ecuri të kënaqshme gjatë vitit 2005. Rritja vëllimit të shitjeve, e të ardhurave tatimore dhe e kredisë për ekonominë dëshmojnë për një rritje të aktivitetit ekonomik në vend. Shitjet totale të ekonomisë kanë shënuar një rritje vjetore prej 21.54 për qind gjatë tremujorit të dytë. Gjithashtu, shitjet janë rritur me 30.9 për qind në krahasim me tremujorin e parë të vitit, rritja më e lartë kjo e tre viteve të fundit, duke treguar gjallërim të prodhimit në të gjithë sektorët e ekonomisë.



Sektorët që kanë shënuar rritje më të lartë, në bazë vjetore, janë “Energjia elektrike, ujë dhe gaz”, “Transporti dhe telekomunikacioni” dhe “Ndërtimi”.

Gjithsesi, peshën më të madhe në shitjet e ekonomisë së vendit e ka sektori i tregtisë dhe i shërbimeve me 42 për qind të shitjeve në total, i ndjekur nga sektori i industrisë me 26 për qind. Si rezultat, këta sektorë kanë dhënë dhe kontributin më të madh në rritjen vjetore të shitjeve të ekonomisë gjatë tremujorit të dytë të vitit, përkatësisht me 7.4 dhe 5.8 pikë përqindje.




II.1.1 Ecuria e prodhimit sipas sektorëve të ekonomisë

Sektori i ndërtimit

Sektori i ndërtimit ka qenë një nga sektorët më aktivë të ekonomisë shqiptare gjatë viteve të fundit. Gjatë tremujorit të dytë, shitjet në këtë sektor u rritën me rreth 24.8 për qind ndaj të njëjtës periudhë të vitit të kaluar dhe me 44.2 për qind ndaj tremujorit paraardhës. Këto ritme rritjeje tregojnë një kërkesë të lartë për zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës, të


kapaciteteve prodhuese, të aktiviteteve tregtare dhe të strehimit. Shitjet e sektorit të ndërtimit përbënë 14.4 për qind të shitjeve totale të ekonomisë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2005, duke kontribuar në rritjen e tyre vjetore me 4.8 pikë përqindjeje. I njëjti kontribut, gjatë dy viteve të shkuara, ka qenë respektivisht 2.5 dhe 0.5 pikë përqindjeje.

Si një sektor në zhvillim, sektori i ndërtimit ka njohur rritje të investimeve private dhe shtetërore. Gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti, fondet e parashikuara për investime u rritën me 3 herë në krahasim me të njëjtin gjashtëmuor të vitit të kaluar. Pas “qetësisë” së tremujorit të parë, tremujori i dytë njohu rritje të ndjeshme të fondit të parashikuar të investimeve. Investimet private vazhdojnë të zënë peshën kryesore dhe destinacioni parësor i tyre mbeten ndërtesat e banimit. Gjithashtu, gjatë këtij tremujori është rritur numri i lejeve të ndërtimit, ku lejet e dhëna për ndërtime banesash janë rritur me rreth 3 herë ndaj vitit të kaluar.



Sektori i tregtisë, hoteleve dhe restoranteve

Shitjet e sektorit “Tregti, hotele dhe restorante” kanë përbërë rreth 43 për qind të shitjeve totale të ekonomisë, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2005. Ky sektor kontribuoi në rritjen vjetore të shitjeve totale të ekonomisë me 6.4 pikë përqindjeje. Si edhe sektorët e tjerë të ekonomisë, sektori “Tregti, hotele dhe restorante” ka shënuar një përmirësim të dukshëm gjatë pjesës së dytë të gjashtëmuajorit. Shitjet e tij u rritën me 17.6 për qind në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2004 dhe me 26 për qind ndaj tremujorit paraardhës.



Kjo ecuri ka respektuar sjelljen sezonale të shitjeve të këtij sektori, sipas të cilës shitjet pësojnë rënie çdo tremujor të parë të vitit, për të shënuar norma pozitive rritjeje, gjatë tremujorëve të tjerë. Gjithsesi, në total, vlerësohet se ecuria e këtij sektori ka kontribuar pozitivisht në zhvillimet e ekonomisë së vendit, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2005.

Kjo ecuri ka respektuar sjelljen sezonale të shitjeve të këtij sektori, sipas të cilës shitjet pësojnë rënie çdo tremujor të parë të vitit, për të shënuar norma pozitive rritjeje, gjatë tremujorëve të tjerë. Gjithsesi, në total, vlerësohet se ecuria e këtij sektori ka kontribuar pozitivisht në zhvillimet e ekonomisë së vendit, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2005.

Sektori i bujqësisë

Prodhimi në sektorin¹ e bujqësisë pritet të rritet me 4.7 për qind këtë vit. Në veçanti, dega e agroindustrialisë pritet të rritet me rreth 12 për qind, rritja më e lartë krahasuar me degët e tjera të bujqësisë. Prodhimi në degën e bujqësisë parashikohet të rritet me 3.1 për qind, e mbështetur kjo nga kushtet pozitive klimaterike, nga rritja e investimeve në serra dhe nga rritja e sipërfaqeve të mbjella. Rritjen më të madhe në degën e bujqësisë pritet ta ketë prodhimi blegtoral me 3.8 për qind krahasuar me një vit më parë. Rritja e prodhimit në këtë degë vjen si rezultat i rritjes së rendimentit në krahasim me një vit më parë.

Nga të dhënat e vëzhgimit të agroindustrialisë për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2005, prodhimi agroindustrial është rritur me 15.7 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës. Kjo është rritja më e madhe (gjashtëmuajor me gjashtëmuajor) e katër viteve të fundit.

¹ Sektori i bujqësisë përfshin degët e bujqësisë, të agroindustrialisë dhe të peshkimit. Dega e bujqësisë përfshin nëndegët e bujqësisë dhe të blegtorisë.

Tabelë 1. Ecuria e prodhimit agroindustrial gjatë gjashtëmuajorit të parë.

	Gjashtëmuaji I 04	Gjashtëmuaji I 05	Ndërshimi (në %)
Totali	13.0	15.0	15.7
Mish dhe nënprodukte	1.3	1.5	17.32
Konservimi i peshkut	0.3	0.4	39.62
Përpunimi fruta-perime	0.2	0.1	-17.86
Vaj	1.1	1.1	-2.04
Çimërcit dhe nënprodukte	2.9	3.0	3.78
Mial dhe bukë	4.0	4.6	15.97
Emëlsina	0.5	0.6	19.26
Pije alkolike	1.3	1.5	12.30
Ujë dhe pije freskuese	1.4	1.8	20.93
Duhan	0.1	0.5	385.71
Të tjerë	0.6	0.6	66.67

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Investimet në sektorin e agroindustrial gjatë gjashtëmuajorit të parë, janë rritur 2.3 herë në krahasim me gjashtëmuajin e parë të vitit paraardhës. Kjo ka ardhur si pasojë e rritjes së investimeve të financuara nga kredi të huaja, rreth 29 herë dhe e rritjes së investimeve të financuara nga kredi bankare, me rreth 2 herë në krahasim me vitin 2004. Këto investime janë përqëndruar kryesisht në rrethet e Tiranës, Shkodrës dhe Dibrës. Sipas aktiviteteve, rritje të investimeve ka në industrinë e miellit, në prodhimin e lëngjeve të ndryshme, në përpunimin e mishit dhe në konservimin e frutave e të perimeve.

Tabelë 2. Investimet në agroindustri gjatë gjashtëmuajorit të parë (në milionë lekë).

	Gjashtëmuaji I 04	Gjashtëmuaji I 05
Me mjetet e reja	572.4	941.7
Me kredi të huaja	0.1	229.9
Me kredi bankare	78.7	763.0

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Sektori i industrisë

Sektori i industrisë ka pasur zhvillime pozitive gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2005, duke kontribuar pozitivisht në ecurinë e shitjeve të ekonomisë gjithsej. Shitjet në këtë sektor janë rritur me 12.14 për qind, gjatë gjysmës së parë të vitit 2005, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2004. Më në detaje, degët e industrisë nxjerrëse, të industrisë përpunuese dhe të "energjisë elektrike, ujë dhe gaz", pas një rënies gjatë tremujorit të parë, kanë shënuar rritje gjatë tremujorit të dytë. Industria përpunuese ka pasur rritjen vjetore më të madhe gjatë gjysmës së parë vitit, por vazhdon të zërë një peshë të vogël në shitjet industriale në total. Në industrinë përpunuese janë rritur kryesisht nëndegët e prodhimit të plastikës, fabrikimi i artikujve mineralë, përpunimi i metaleve dhe industria e letrës. Industria nxjerrëse është rritur me 18.4 për qind gjatë gjashtëmuajorit të parë, e ndikuar kryesisht nga rritja në nxjerrjen e produkteve energjitike.

Tabelë 3. Ecuria e sektorit të industrisë për gjashtëmujorin e parë 2005 (në përqindje).

	Pesha ndaj totalit	Shitje D5/04
Industria gjithëse	700	12.14
Industria ndërmëse	7.2	18.40
Industria përpunuese	65.1	10.26

Burimi: INSTAT.

Sektori i energjitikës

Sektori i energjitikës është zhvilluar në mënyrë të ekuilibruar gjatë tetë muajve të parë të vitit 2005. Konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë janë furnizuar me 1.2 për qind më shumë energji elektrike, ndërkohë që importi dhe eksporti i energjisë janë praktikisht ekuivalentë. Gjithsesi, brenda kësaj periudhe, tremujori i dytë njohu një përmirësim të ndjeshëm të situatës. Gjatë tremujorit të dytë të vitit, indeksi i shitjeve të sektorit “Energji elektrike, ujë, gaz”, shënoi një rritje vjetore prej 34.6 për qind dhe një rritje prej 9.5 për qind në krahasim me tremujorin paraardhës.


Tabelë 4. Të dhënat për furnizimin dhe përdorimin e energjisë elektrike.

	Janar – gusht 04 (GWh)	Janar – gusht 05 (GWh)	Ndryshimi vjetor (%)
Furnizimi total	4,053	4,641	6.6
- Prodhimi	3,954	4,061	2.7
- Importi	998	579	45.4
Përdorimi total	4,353	4,641	6.6
- Eksporti	302	581	92.1
- Konsum familjar	1,485	1,450	2.3
- Konsum jofamiljar	1,019	1,083	6.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës janar – gusht '05, sasia e furnizuar e energjisë në vend është rritur me 6.6 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2004. Prodhimi në vend mbuloi 87.5 për qind të furnizimit me energji, ndryshe nga tetëmujori i parë i vitit të kaluar, kur ky prodhim mbuloi 91 për qind.

Ndërkohë, sasia e importuar e energjisë u rrit në krahasim me periudhën janar – gusht '04, duke siguruar 12.5 për qind të furnizimit të energjisë, në vend të 9 për qind dhënë gjatë vitit të kaluar. E njëjta dinamikë është ruajtur në ecurinë e eksporteve. Gjatë periudhës në fjalë, 12.5 për qind e furnizimit me energji shkuan për eksporte në krahasim



me vetëm 7 për qind të eksportuar gjatë tetëmuorit të parë të vitit 2004.

Megjithëse përdorimi i energjisë nga ana e konsumatorëve familjarë ka rënë në nivel vjetor me 2.3 për qind, ai vazhdon të zërë peshën kryesore (57 për qind) në përdorimin e energjisë. Nga ana tjetër, konsumi i energjisë nga jofamiljarët, për tetë muajt e parë të këtij viti është rritur me rreth 6.3 për qind, në krahasim me vitin e kaluar.

Sektori i transportit

Pas një rënijeje të indeksit të shitjeve të sektorit të transportit gjatë tremujorit të parë të vitit, ky sektor ka shfaqur zhvillime të kënaqshme gjatë tremujorit të dytë, duke shënuar një rritje të këtij indeksi me 25.34 për qind. Kjo është rritja më e lartë me bazë tremujore, që nga tremujori i katërt i vitit 2001. Në krahasim me tremujorin e dytë të një viti më parë, indeksi i shitjeve është rritur me 30.57 për qind, duke kontribuar me 3.66 pikë përqindjeje në rritjen totale të indeksit të shitjeve të të gjithë ekonomisë.

Vëllimi i punës në transportin detar pati një rritje me 9 për qind, gjatë tetëmuorit të parë të këtij viti. Importet në porte patën një rritje prej 5 për qind, ndërkohë që eksportet ranë me 2.1 për qind. Portet e Vlorës dhe të Sarandës patën rritjen më të ndjeshme të vëllimit të punës gjatë 8 muajve të parë të vitit, por ato zënë vetëm 13 për qind peshë të vëllimit të punës të të katër porteve të vendit. Vëllimi i punës në Portin e Durrësit zuri për këtë periudhë rreth 80 për qind të vëllimit të punës. Transporti hekurudhor pësoi një ulje të numrit të udhëtarëve dhe të vëllimit të mallrave të transportuar. Vëllimi i punës ra përkatësisht 13.2 për qind për mallrat dhe 23.6 për qind për udhëtarët, në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë. Gjatë gjashtëmuorit të parë të këtij viti transporti ajror është rritur me 27 për qind të numrit të fluturimeve, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Investimet në sektorin e transportit gjatë gjashtë muajve të parë kanë rënë me 31 për qind, krahasuar me gjashtëmuorin e parë të vitit 2004.

Sektori fiskal

Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, deri në fund të muajit shtator, janë mbledhur 97.5 për qind e të ardhurave të planifikuara dhe është realizuar rreth 96.4 për qind e shpenzimeve të programuara. Deficiti buxhetor, në fund të muajit shtator, ishte rreth 18.9 miliardë lekë, nga 21.4 miliardë lekë të parashikuara. Financimi i brendshëm i deficitit deri në muajin shtator arriti në 15.2 miliardë lekë, përkundrajt nivelit prej 13.5 miliardë lekësh të parashikuar, duke tejkaluar planin me 12.5 për qind. Ndërsa financimi i huaj i deficitit u arrit deri në 48.4 për qind të vlerës së parashikuar.


Gjatë tremujorit të tretë, është vënë re një ngadalësim i fluksit të të ardhurave, duke sjellë edhe ngadalësimin e shpenzimeve buxhetore. Arsyeja kryesore që ka ndikuar në uljen e ritmit të grumbullimit të të ardhurave tatimore ishte procesi i gjatë pazelektoral. Kjo periudhë është shoqëruar edhe me përqendrimin e huamarrjes së qeverisë, e cila ndonëse ka respektuar kufijtë vjetorë, ka krijuar vështirësi në administrimin e situatës së likuiditetit. Banka e Shqipërisë vlerëson se rivendosja dhe forcimi i administrimit fiskal si dhe respektimi i kriterëve të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik, duhet të mbeten një përparësi konstante

e politikës fiskale.

Tabelë 5. Ritmet e rritjes së treguesve fiskalë (në përqindje).

	Jan.-Sht. 00/99	Jan.-Sht. 01/00	Jan.-Sht. 02/01	Jan.-Sht. 03/02	Jan.-Sht. 04/03	Jan.-Sht. 05/04
Të ardhura	13.7	4.3	17.7	12.8	9.8	7.8
Shpenzime	4.5	1.4	9.4	8.3	8.1	6.9
- Shpenzime kapitale	22.2	24.8	-18.5	14.8	4.2	8.8
Deficiti	(15.7)	(8.9)	(18.2)	(13.1)	(2.4)	0.6

Burimi: Ministria e Financave.




Të ardhurat buxhetore

Të ardhurat buxhetore kanë qenë rreth 7.8 për qind më të larta gjatë periudhës janar – shtator 2005, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2004. Niveli i të ardhurave tatimore, në fund të muajit shtator, arriti në rreth 130.8 miliardë lekë. Tatimet e mbledhura nga doganat rezultuan rreth 9.5 miliardë lekë, duke realizuar nivelin e parashikuar në projektbuxhetin e fillimvitit respektivisht me 99.7 për qind.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar përbën burimin kryesor të të ardhurave tatimore. Gjatë nëntë muajve të parë të vitit është vënë re se ritmi i rritjes së të ardhurave nga TVSH-ja, është 8 pikë përqindje më i ulët se mesatarja e rritjes së këtij treguesi në tre vitet e fundit.

Periudha korrik-shtator 2005 ka shfaqur një ngadalësim të ritmit të punës së organeve fiskale. Të ardhurat në total janë rritur në masën 6.1 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke përfaqësuar nivelin më të ulët të rritjes së të ardhurave në katër vitet e fundit. Të ardhurat nga akcizat dhe të ardhurat nga pushteti lokal kanë patur performancën më të mirë të të ardhurave. Ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat jotatimore kanë rënë me 10.8 për qind.



Tabelë 6. Ritmet e rritjes së të ardhurave gjatë viteve 2002-2005 (në përqindje).

	Ko. Sht. 02/01	Ko. Sht. 03/02	Ko. Sht. 04/03	Ko. Sht. 05/04	Mesatare 02-05	Real. Planit Shtator 05
Totali të ardhurave	11.3	9.9	14.3	6.1	10.4	97.5
Të ardhura tatimore	18.4	35.8	16.2	8.6	19.8	99.7
Nga tatimet dhe doganat	16.2	4.0	16.8	8.0	11.7	99.4
Tanmi mbi vlerën e shtuar	14.3	5.3	17.4	10.4	11.8	99.8
Tanmi mbi fitimin	21.0	0.8	31.5	9.7	15.7	113.9
Aktivat	4.8	21.0	42.8	17.7	20.1	98.9
Tanmi mbi të ardhurat personale	35.0	4.2	4.7	10.5	13.6	95.6
Taksa doganore	7.2	1.6	(0.1)	1.4	2.5	89.3
Të ardhura nga pushteti lokal	40.1	284.5	1.2	22.4	67.0	108.2
Të ardh. buxh. paratur (kontribute)	12.2	9.5	18.3	7.3	11.8	98.2
Të ardhura jo-tatimore	(23.2)	(7.8)	1.9	(10.8)	(10.0)	87.4

Burimi: Ministria e Financave.


Shpenzimet buxhetore.

Shpenzimet buxhetore gjatë nëntë muajve të parë të vitit ishin 161.8 miliardë lekë, duke përbërë rreth 96.4 për qind të nivelit të programuar për këtë periudhë. Shpenzimet e personelit, të cilat përbëjnë rreth 27 për qind të shpenzimeve korente dhe 24 për qind të shpenzimeve totale, u realizuan në masën 99.7 për qind.

Shpenzimet kapitale, edhe pse në rritje të konsiderueshme gjatë periudhës janar-shtator të këtij viti, vazhdojnë të jenë poshtë nivelit të planifikuar, duke arritur masën 80.4 për qind të planit. Nga këto të fundit, shpenzimet e mbuluara me financim të brendshëm dhe të huaj u realizuan respektivisht në masën 99.3 dhe 57.6 për qind.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, shpenzimet totale janë rritur me 3.4 për qind gjatë periudhës korrik-shtator të vitit 2005. Gjatë këtij tremujori vërehet se shpenzimet e personelit dhe ato të kontributeve për sigurime shoqërore kanë patur rritjen më të lartë në shpenzimet korente.

Ndërkohë, shpenzimet operative të mirëmbajtjes dhe ato për interesa janë zvogëluar, duke qenë poshtë nivelit të planifikuar. Shpenzimet kapitale kanë pësuar një tkurrje gjatë kësaj periudhe, por sjellja e tyre gjatë viteve paraqitet e çrregullt, gjë që tregon se ecuria e këtyre shpenzimeve ndikohet mjaft nga ecuria e projekteve të caktuara. Në shpenzimet kapitale vihet re pesha gjithnjë në rritje e financimit të brendshëm kundrejt atij të huaj.



Tabelë 7. Ritmet e rritjes së shpenzimeve gjatë viteve 2002-2005 (në përqindje).

	Ka.-Sht. 02/01	Ka.-Sht. 03/02	Ka.-Sht. 04/03	Ka.-Sht. 05/04	Mesatar 4 02-05	Real. Planit Shtator 05
TOTALI SHPENZIMEVE	10.7	5.9	11.2	3.4	7.8	96.4
Shpenzime Korrente	12.3	10.3	10.9	5.4	10.0	101.4
Personeli	0.9	0.5	15.8	11.2	7.1	99.7
Paga	0.2	1.2	16.3	11.4	7.3	101.3
Kontributi për Sigurime Shpërndare	3.6	(1.9)	13.7	10.7	6.5	96.2
Interesat	11.7	24.5	4.9	(3.8)	9.3	89.7
Të brendshme	8.9	(23.5)	76.3	(4.4)	14.3	91.2
Të huaja	72.9	(26.4)	(2.6)	9.4	13.2	70.3
Shpenzime operative për mirëmbajtje	34.0	(0.8)	14.1	(5.8)	10.4	112.5
Shpenzime për sigurime sociale dhe transfer me të tjera	18.7	20.5	(16.9)	9.2	7.9	99.6
Shpenzime kapitale	2.1	(10.6)	13.1	(5.7)	(0.3)	80.4
Financimi i brendshëm	(22.0)	12.7	34.9	(2.9)	5.7	99.3
Financimi i huaj	43.0	(32.2)	(20.6)	(12.8)	(5.7)	57.6

Burimi: Ministria e Financave.

Deficiti fiskal

Deficiti buxhetor, gjatë nëntë muajve të parë të vitit, ishte afërsisht 88.9 për qind e nivelit të planifikuar. Peshën kryesore në financimin e deficitit e mban financimi i brendshëm, i cili është realizuar në masën 112.5 për qind të planit, ndërkohë që financimi i huaj u realizua me vetëm 48.4 për qind. Gjatë periudhës korrik-shtator 2005, deficiti ka shënuar një rënie prej 8.6 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tabelë 8. Ritmet e rritjes së deficitit gjatë viteve 2002-2005 (në përqindje).

	Ka.-Sht. 02/01	Ka.-Sht. 03/02	Ka.-Sht. 04/03	Ka.-Sht. 05/04	Mesatar 02-05	Real. Planit Shtator 05
Deficit	8.7	(7.3)	(0.8)	(8.6)	(2.0)	88.9
Financim brendshëm	(61.5)	206.3	4.3	(8.5)	35.1	112.5
Financim i huaj	149.9	(73.5)	(19.3)	(9.2)	12.0	48.4

Burimi: Ministria e Financave.

Tregu i punës


Tregu i punës gjatë vitit 2005 vazhdoi të ruajë ecurinë e mirë që manifestoi në fundin e vitit 2004, ku treguesit e punës shfaqën një tendencë të fortë rritjeje. Kështu, numri i të punësuarve është rritur me 10 mijë vetë, krahasuar me tremujorin e dytë të një viti më parë. Të punësuarit në sektorin privat jobujqësor janë rritur me 5400 vetë, duke qenë një tregues i rëndësishëm i gjallërimit të aktivitetit ekonomik.

Tabelë 9. Treguesit e tregut të punës (në mijë vetë).

	2002	2003	2004				2005	
			Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV	Tr.I	Tr.II
Farecat e punës gjithësej (në mijë)	1167	1093	1080	1081	1080	1058	1067	1086
A. Të punësuar gjithësej (në mijë)	991	927	919	921	922	931	931	931
(i) në sektorin shtetëror	189	184	179	179	177	176	176	175,4
(ii) në sektorin privat jobujqësor	160	209	206	208	211	219	219	219,4
(iii) në sektorin privat bujqësor	644	534	534	534	534	542	542	542
B. Papunësia (në mijë)								
(i) të papunë gjithësej	175,5	165,8	161	160	158	157	156	155
(ii) përfitojnë pagesë pa punësi	12,3	11	11,7	12,3	12	11	11,5	11,5
C. Shkalla e papunësisë (në %)	15,1	15,2	14,9	14,8	14,6	14,4	14,4	14,3

Burimi: INSTAT, Konjuktura shtator, 2005.

Tregu i punës nuk pati ndryshime në strukturën e tij, gjatë vitit 2005. Kështu, sektori shtetëror megjithë uljen e numrit të të punësuarve, vazhdon të zërë rreth 19 për qind të numrit total. Ai privat jobujqësor zë 23 për qind dhe ai privat bujqësor 58 për qind të të gjitha forcave të punës². Ndryshimet më të rëndësishme këtë tremujor ndodhën në shifrën e papunësisë. Papunësia është ulur me 0.5 pikë përqindjeje në krahasim me një vit më parë. Në tremujorin e dytë numri i të papunëve ka rënë me një mijë vetë, duke e çuar normën e papunësisë në 14.3 për qind. Një tregues tjetër që shpreh këtë fakt është edhe numri i personave që fitojnë pagesë papunësie. Ky numër ka ardhur duke u ulur me 1.1 mijë persona në krahasim me qershorin e vitit 2004.




Përmirësimi i treguesve të punësimit duket se është shoqëruar edhe me rritjen e të ardhurave. Të dhënat për strukturën e pagave në sektorin shtetëror, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2005, tregojnë se paga mesatare shtetërore është rritur me 2 për qind, krahasuar me mesataren e tremujorit parë të vitit 2005. Në terma vjetorë (tremujor me tremujor), paga mesatare shtetërore është rritur me gati 10 për qind. Megjithatë të dhënat e tregut të punës vazhdojnë të kenë deformime në treguesit, që janë rezultat i veprimit të fenomeneve të tilla si: migrimi i pakontrolluar i popullsisë që ka sjellë ndryshim të vazhdueshëm të raportit të popullsisë rurale dhe asaj urbane, si dhe vazhdimi i ekzistencës së tregut të zi të punës, relativisht të gjerë.

² Në ndryshim nga dy sektorët e parë, për të cilët të dhënat mund të konsiderohen brenda standardeve statistikore, për sektorin e tretë shifra duhet të merret me rezerva. Ajo nuk shpreh lëvizjet që mund të ndodhin gjatë tremujorëve të vitit (në fakt vlera mbetet e pandryshuar gjatë vitit) duke u bërë e përdorshme vetëm në fund të vitit, kur dalin dhe rezultatet e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës mbi të cilën ajo bazohet.

II.1.4 Sektori i jashtëm

Transaksionet korente dhe kapitale të vendit me pjesën tjetër të botës kanë qenë pothuajse të balancuara, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2005. Gjatë kësaj periudhe është regjistruar një bilanc i përgjithshëm i pagesave prej 11 milionë eurosh. Deficiti në tregtinë e mallrave dhe të shërbimeve ka qenë burimi kryesor i deficitit korent. Ky i fundit ka shënuar rreth 145 milionë euro, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Llogaria kapitale dhe financiare ka regjistruar hyrje neto prej rreth 197 milionë eurosh, ndërkohë që rezervat valutore të autoritetit monetar janë rritur me rreth 7 milionë euro, gjatë kësaj periudhe. Deficiti i vazhduar në tregtinë e mallrave gjatë viteve të fundit, është kompensuar nga hyrjet korente në formën e të ardhurave nga emigrantët, si edhe nga hyrjet kapitale dhe financiare në formë grantesh, borxhi qeveritar dhe privat dhe investimet direkte.




Llogaria korente

Deficiti korent i Shqipërisë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2005, ishte 145 milionë euro ose rreth 10 për qind më i lartë se deficiti i regjistruar në gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar. Pjesa dërrmuese e pagesave korente ka mbuluar importet e mallrave (64 për qind) dhe ato të shërbimeve (34 për qind), ndërkohë që të ardhurat korente janë siguruar kryesisht nga transfertat private (37 për qind), shërbimet (35 për qind) dhe eksportet e mallrave (20 për qind).

Tregtia në mallra zë pjesën më të madhe në vëllimin e transaksioneve korente të vendit me botën. Vëllimi i përgjithshëm tregtar i gjashtëmujorit të parë të vitit 2005 ishte rreth 1.2 miliardë euro, nga të cilat rreth 900 milionë euro kanë qenë pagesa për importet dhe 260 milionë euro të ardhura nga eksportet. Rritja vjetore e importeve për gjashtëmujorin e parë ishte 14 për qind, ndërkohë që eksportet u rritën me 11 për qind. Mbulimi i importeve nga eksportet vazhdon të jetë i ulët. Pjesa më e madhe e importeve përfaqësohen nga mallra të ndërmjetëm, ndërkohë që importet e mallrave kapitalë kanë shënuar një rritje të dukshme në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar. Këto zhvillime janë tregues të një ecurie të mirë të industrisë përpunuese dhe të ecurisë së investimeve në vend. Eksportet shqiptare vazhdojnë të demonstrojnë një shkallë të ulët diversifikimi, duke u përfaqësuar kryesisht nga riekportet. Vendet e Bashkimit Evropian vazhdojnë të jenë burimi dhe destinacioni kryesor i tregtisë së jashtme.

Tregtia në shërbime, zë një vëllim më të vogël se tregtia në mallra. Vëllimi i transaksioneve në shërbime, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2005, ishte rreth 930 milionë euro ose 20 për qind më i lartë se ai për të njëjtën periudhë për vitin e kaluar. Llogaria e shërbimeve

është mbyllur me një deficit prej 43 milionë eurosh. Shërbimet e turizmit përfaqësojnë nëngrupin me të ardhurat dhe shpenzimet më të larta në kategorinë e shërbimeve. Këto shërbime kanë siguruar rreth 70 për qind të të ardhurave dhe kanë përfaqësuar rreth 60 për qind të pagesave të përgjithshme për shërbime. Aktiviteti i turizmit përfaqëson jo vetëm një nga burimet kryesore të të ardhurave nga shërbimet, por edhe një nga burimet kryesore të të ardhurave në valutë për ekonominë shqiptare. Të ardhurat nga turizmi për gjashtëmujorin e parë të këtij viti, ishin 17 për qind më të larta se ato të vitit të kaluar, si pasojë e rritjes së numrit të turistëve të huaj si edhe e rritjes së shpenzimeve ditore të tyre. Megjithatë, gjatë dy viteve të fundit është vërejtur një rritje e shpenzimeve të turistëve shqiptarë jashtë vendit, gjë që ka çuar në një ngushtim të bilancit pozitiv të kësaj kategorie.



Kategoria e të ardhurave ka regjistruar një suficit prej rreth 66 milionë eurosh. Të ardhurat nga puna e punonjësve sezonalë përfaqësojnë burimin kryesor të të ardhurave, ndërkohë që shpenzimet për interesat e borxhit të jashtëm janë zëri kryesor në kahun e shpenzimeve. *Transferta korentë* edhe për këtë gjashtëmujor kanë regjistruar një bilanc thellësisht pozitiv, duke shërbyer si kundërbalancues të deficitit tregtar në mallra dhe shërbime. Prurjet e emigrantëve kanë qenë rreth 420 milionë euro duke përbërë rreth 76 për qind të vëllimit të përgjithshëm të transfertave, ndërkohë që pjesa tjetër është siguruar nga transfertat shtetërore në formë të asistencës teknike.

Llogaria kapitale dhe financiare

Hyrjet neto në llogarinë kapitale dhe financiare, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2005, kapën nivelin 200 milionë euro. Suficiti në llogarinë kapitale dhe financiare gjatë viteve të fundit ka financuar deficitin korent edhe në këtë periudhë. Si llogaria kapitale, ashtu edhe ajo financiare kanë shënuar flukse neto pozitive përkatësisht në nivelet 50 dhe 150 milionë euro. Edhe pse flukset pozitive të kapitalit përkthehen në rritje të stokut të detyrimeve financiare të vendit ndaj pjesës tjetër të botës, aspekti pozitiv i këtyre zhvillimeve qëndron në faktin që Shqipëria mbështetet më tepër në investimet direkte sesa në huamarrjen afatgjatë nga jashtë. Investimet e huaja direkte për këtë gjashtëmujor kanë qenë rreth 100 milionë euro, ndërsa huamarrja nga jashtë rreth 80 milionë euro. Investimet direkte të kësaj periudhe kanë qenë më tepër të orientuara ndaj investimeve të reja në krahasim me vitin e kaluar, kur të ardhurat nga privatizimi siguruan pjesën dërrmuese të këtyre investimeve. Pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj botës, të përfaqësuara kryesisht nga investimet e portofolit dhe nga depozitat e bankave rezidente me bankat jorezidente, kanë shënuar një rritje prej rreth 26 milionë eurosh. Stoku i mjeteve financiare në formën e investimeve të portofolit, në fund të periudhës kapi shumën 164 milionë euro, me një fluks gjashtëmujor në rritje prej 48 milionë eurosh. Mjetet valutore të zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë, kanë rënë me rreth 37 milionë euro. Gjithashtu, në rënie vlerësohen mjetet valutore cash. Në përbërjen strukturore sipas monedhave, mjetet valutore cash në dollarë amerikanë zinin 39 për qind dhe ato në euro 53 për qind. Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të

rezervave valutore të autoritetit monetar me rreth 11 milionë euro. Niveli i rezervave valutore bruto, në fund të periudhës, u vlerësua në 1 miliard e 72 milionë euro duke qenë i mjaftueshëm për të përballuar 4.6 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Tabelë 10. Ecuria e bilancit të pagesave (në milionë euro).

	GJ1-04	GJ1-05
1. Llogaritja korrente	-131.8	-145.2
A. Mallra	-551.5	-640.2
A.1. Importe	-790.5	-905.0
A.2. Eksporte	239.0	264.8
B. Shërbime	-6.7	-42.8
B.1. Importe	-368.7	-484.0
B.2. Eksporte	362.0	441.2
C. Të ardhura	57.5	65.9
C.1. Dajë	-11.4	-14.5
C.2. Hyrje	68.9	80.4
D. Transferime korrente	369.2	471.9
2. Llogaritja kapitale	48.5	50.1
3. Llogaritja financiare	202.0	146.4
4. Krija e rezervave	-109.7	-6.6
5. Gëzime dhe harrime	-13.9	-44.7
6. Bilanci i përgjithshëm	109.7	6.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

II.2 ECURIA E INFLACIONIT GJATË TREMUJORIT TË TRETË

Inflacioni vjetor shënoi një rritje graduale gjatë tremujorit të tretë, duke treguar një ecuri të ndryshme nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Inflacioni vjetor u rrit nga 1.8 për qind në muajin korrik, në 3.1 për qind në muajin shtator. Megjithatë, presionet dhe pritjet inflacioniste mbetën nën kontroll. Kështu, inflacioni ka qenë brenda objektivit 2-4 për qind të Bankës së Shqipërisë, gjatë tremujorit të tretë. Norma mesatare vjetore e inflacionit nuk ka shënuar ndryshime gjatë tremujorit të tretë, duke u luhatur në intervalin 2.2-2.3 për qind.

Tabelë 11. Norma vjetore e inflacionit (në përqindje).

	2001	2002	2003	2004	2005
Janar	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3
Shkurt	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8
Mars	2.9	7.5	1.3	4.0	1.6
Prill	3.0	6.5	2.3	3.2	1.3
Maj	2.5	4.6	2.8	2.6	2.0
Qershor	4.0	3.7	2.6	2.9	2.9
Korrik	5.6	4.2	3.0	3.1	1.8
Gusht	4.1	5.5	3.0	2.7	2.3
Shtator	3.5	5.3	2.8	2.0	3.1
Tetor	1.8	5.8	2.9	2.0	
Nëntor	2.8	3.7	3.4	2.2	
Dhjetor	3.5	1.7	3.3	2.2	
Mesatar	3.1	5.2	2.2	3.0	2.2

Burimi: INSTAT.

Rritja e inflacionit gjatë tremujorit erdhi si pasojë e frenimit të rënies sezonale të çmimeve të prodhimeve ushqimore, e kombinuar kjo edhe me presionet inflacioniste që solli rritja e çmimit të naftës, në mënyrë të veçantë në muajt gusht e shtator.

II.2.1 Ecuria e inflacionit dhe e grupeve përbërëse



Gjatë tremujorit të tretë të këtij viti, inflacioni vjetor shënoi ndryshime në madhësi dhe në kah kundrejt së njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Krahasuar me një vit më parë, ecuria e inflacionit vjetor është përcaktuar nga kontributi i grupeve “Ushqime dhe pije joalkolike” e “Transport”. Në ndryshim nga vjet, grupi i parë ka shënuar norma pozitive të inflacionit vjetor ndërsa grupi i dytë gati ka dyfishuar normën e inflacionit vjetor³.

Grupi “Ushqime dhe pije joalkolike” ka ndryshuar sjelljen gjatë tremujorit të tretë të vitit 2005, duke mos kontribuar në uljen e inflacionit vjetor. Kontributi i tij në inflacionin vjetor gjatë tremujorit të tretë është zero, ndërkohë që një vit më parë ai ka kontribuar në rënien me 1.2 pikë përqindjeje të inflacionit vjetor.

Arsyeja kryesore e kësaj sjelljeje është prania e një efekti më të dobët sezonal gjatë stinës së verës, duke u shfaqur në uljen graduale të ofertës së prodhimeve ushqimore vendase gjatë tremujorit.

Gjithashtu, rritja e inflacionit të këtij grupi ka reflektuar edhe inflacionin e importuar. Çmimet e mallrave ushqimorë në Greqi, nga ku importohen pjesa më e madhe e këtyre prodhimeve, kanë shënuar çmime të larta, të pazakonta për këtë periudhë.

Në total, pamundësia e ofertës vendase për të përmbushur kërkesat e tregut dhe futja e prodhimeve të importit me çmime më të larta, ka rezultuar në rritjen e përgjithshme të çmimeve.



³ Inflacioni vjetor i këtij grupi u rrit nga 3.3 për qind në muajin shtator 2004, në 6 për qind në muajin shtator të këtij viti.

Tabelë 12. Inflacioni i grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” dhe pesha e tij në inflacionin total.

	Inflacioni vjetor'04	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor'05	Kontributi (pp)	Indi ⁴ Inflacioni vjetor'05	Greqi ⁵ Inflacioni vjetor'05
Pril	0.1	0.1	-2.3	-1.0	-0.2	-0.1
Maj	-1.1	-0.5	-0.7	-0.9	-0.3	-0.4
Qershor	-0.7	-0.3	1.6	0.7	-0.2	-0.5
Korrik	-0.1	0.0	-1.6	-0.7	-0.3	0.7
Gusht	-1.4	-0.6	0.0	0.0	-0.2	1.3
Shtator	-2.9	-1.2	1.5	0.6		

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kontributi i grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji elektrike” është luhatur në vlera më të ulëta sesa një vit më parë. Megjithatë, ky grup vazhdon të japë kontributin kryesor në inflacionin total. Inflacioni i këtij grupi përbën rreth 65 për qind të inflacionit total vjetor gjatë tremujorit të tretë. Në muajin shtator, inflacioni vjetor i grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji” shënoi një vlerë 7.7 për qind, nga 6.9 për qind që ishte një muaj më parë. Në këtë shifër ka ndikuar rritja e çmimit të qirasë dhe rentës së imputuar në nivelet 3.3 për qind, si rezultat i periudhës së vitit të ri shkollor që solli një rritje të kërkesës për ambiente banimi.

Tabelë 13. Inflacioni i grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji” dhe pesha e tij në inflacionin total.

	Inflacioni vjetor'04	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor'05	Kontributi (pp)
Pril	11.0	2.5	7.2	1.8
Maj	10.0	2.3	7.3	1.8
Qershor	9.7	2.0	7.1	1.9
Korrik	9.9	2.4	7.7	2.0
Gusht	9.7	2.4	6.9	1.8
Shtator	10.4	2.5	7.7	2.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë tremujorit të tretë të këtij viti, dhe në mënyrë të veçantë në muajt gusht dhe shtator, ka patur një rritje të ndjeshme të çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar. Ky fakt ka sjellë rritjen e ndjeshmërisë të operatorëve ndaj rritjes së çmimit botëror të naftës, duke u manifestuar në rritje të njëpasnjëshme në muajt gusht-shtator të çmimit të saj edhe në tregun vendas. Si rezultat, grupi “Transport” ka pësuar rritjen më të lartë që prej muajit shtator të vitit të kaluar, ndërsa nëngrupi “Shërbime ndaj mjeteve personale”⁶ është rritur me 12.2 për qind. Kontributi i këtij grupi në normën e inflacionit gjatë këtij tremujori ka qenë 0.7 pikë përqindjeje. Pështja e ulët e këtij grupi në indeksin e çmimeve të konsumit nuk është aq e madhe sa të bëhet përcaktuese direkt për ndryshime të rëndësishme në normën e inflacionit. Gjithashtu, mbiçmimi i lekut ndaj euros dhe usd në terma vjetorë, ka zbutur përcjelljen e këtij efekti në inflacion.

⁴ Burimi: ISTAT; faqja e internetit <http://www.istat.it>

⁵ Burimi: Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Statistikor Kombëtar i Greqisë; faqja e internetit: <http://www.statistics.gr>

⁶ Inflacioni vjetor i këtij nëngrupi për muajt korrik dhe gusht'05 është përkatësisht 8.8 dhe 10.3 për qind.

Kontributet e grupeve të tjera janë luhatur në mënyrë të moderuar gjatë këtij tremujori. Megjithëse me peshë të vogël, rritja e pagesave arsimore ka ndikuar në rritjen e inflacionit gjatë këtij tremujori. Grupet e tjera të shportës⁷ kanë ndikuar, në përgjithësi, në uljen e normës vjetore të inflacionit duke zbutur rritjet e çmimeve në grupet e sipërpërmendura.

II.2.2 Ambienti makroekonomik dhe çmimet e konsumit.



Ambienti makroekonomik në vend ka qenë përgjithësisht i favorshëm për kontrollin e inflacionit. Ai është karakterizuar nga një ecuri e mirë e shitjeve në ekonomi⁸, nga një situatë e qëndrueshme në tregun e punës dhe nga ruajtja e mbigjimit vjetor të lekut ndaj euros dhe dollarit. Gjithashtu, ekonomia nuk ka pësuar *shock* nga ana e kërkesës ndërkohë që *shock*-u i çmimeve të naftës, i cili vepron nga ana e ofertës, është amortizuar mjaft nga leku i fortë. Në këto rrethana, ky tremujor nuk u karakterizua nga ndryshime strukturore të rëndësishme në luhatjen e grupeve të ndryshme të shportës së mallrave të konsumit.

Faktorët e kërkesës

- **Politika fiskale dhe treguesit fiskalë.**

Treguesit fiskalë kanë qenë brenda niveleve të parashikuara në programin e buxhetor, gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit. Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore nuk e kanë tejkaluar tavanin e vendosur për këtë periudhë. Deri në muajin shtator, ato janë realizuar respektivisht në masën 97.5 për qind dhe 96.4 për qind të planit, duke bërë që edhe deficitin buxhetor të jetë brenda parametrave të parashikuar. Në këtë mënyrë, politika fiskale ka dhënë një kontribut të vlefshëm në ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë.

Megjithatë, përqendrimi i deficitit buxhetor gjatë tremujorit të tretë ka krijuar probleme likuiditeti për sistemin bankar dhe ka rritur luhatshmërinë e normave të interesit në treg. Ky fakt, nënvizon rëndësinë që ka respektimi tërësor i treguesve të parashikuar buxhetorë në ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë.




⁷ “Komunikimi”, “Hotele, kafene dhe restorant”, “Veshje dhe këpucë” etj..

⁸ Indeksi i Shitjeve për të gjithë ekonominë shënoi një rritje vjetore prej 21.6 për qind, gjatë tremujorit të dytë.

- **Politika monetare dhe treguesit monetarë.**

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë gjatë tremujorit të tretë ka patur një kah neutral. Pas një periudhe të gjatë lehtësimi të kushteve monetare në ekonomi, Banka e Shqipërisë ka synuar stabilitetin e normave të interesit në treg. Megjithatë, si pasojë e ndryshimit të shpejtë të situatës së likuiditetit, normat e interesit kanë shënuar luhatje të dukshme gjatë tremujorit të tretë. Megjithë vështirësitë e natyrës operacionale për administrimin e likuiditetit që ka sjellë kjo situatë, ekuilibrat e treguesve monetarë nuk kanë patur shmangie të theksuara dhe nuk janë përcjellë në inflacion.



Raporti i parashë jashtë bankave ndaj M3 ka qenë relativisht i qëndrueshëm, ndërsa rritja e ofertës monetare i ka korresponduar nevojave të ekonomisë për mjete monetare. Në përgjithësi, politika monetare nuk ka dhënë shtysa për rritjen e inflacionit.

- **Tregues të tjerë të kërkesës së brendshme.**

Kërkesa e brendshme ka shënuar rritje gjatë tremujorit të dytë të vitit. Indeksi i shitjeve të ekonomisë ka shënuar një rritje vjetore prej 21.6 për qind. Në krahasim me tremujorin paraardhës ky indeks u rrit ndjeshëm në 31 për qind, duke evidentuar gjallërimin e aktivitetit ekonomik pas tremujorit të parë.

Gjithashtu, një rritje prej 9.4 për qind ndaj tremujorit paraardhës ka regjistruar dhe Indeksi i Tregtisë me Pakicë. Gjithsesi, duke gjykuar performancën dhe dinamikën e treguesve të inflacionit, vlerësohet se rritja e kërkesës nuk ka përcjellë presione inflacioniste në ekonomi.

Faktorët e ofertës.

- **Kursi i këmbimit dhe inflacioni i importuar.**

Tendenca mbiçmuese e lekut ndaj euros dhe dollarit vazhdon të jetë e dukshme dhe gjatë tremujorit të tretë të vitit 2005. Megjithëse me një dinamikë vjetore më të zbutur, leku ka shënuar një mbiçmim mesatar vjetor me 1.4 dhe 1.0 për qind ndaj dollarit amerikan dhe euros gjatë këtij tremujori. Mbiçmimi i kursit të këmbimit është një nga faktorët kryesorë që ka lehtësuar dhe absorbuar presionet inflacioniste në vend, sidomos të inflacionit të importuar.

Qëndrueshmëria e jashtme si dhe zhvillimet e favorshme në kursin e këmbimit kanë kufizuar *shock*-et me natyrë të jashtme mbi ecurinë e çmimeve. Nga ana tjetër, qëndrueshmëria e kursit të këmbimit shpreh besim tek vlera e lekut dhe tregon për pritje të ulëta inflacioniste në ekonomi.

Tabelë 14. Inflacioni vjetor i vendeve partnere dhe ndryshimet në kursin e këmbimit (në përqindje) për vitin 2005.

	Mars	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
Greqi ⁹	2.9	3.3	3.9	3.7	3.9
Itali ¹⁰	1.9	1.8	2.1	2.0	
Lek/Euro	-3.1	-1.0	-1.6	-2.4	-1.4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

• **Ecuria e prodhimit të brendshëm bujqësor.**

Parashikimet e bëra nga Ministria e Bujqësisë për prodhimin e brendshëm bujqësor për vitin 2005, flasin për një rritje vjetore prej 3.1 për qind. Kjo rritje mbështetet nga kushtet e mira klimaterike, nga rritja në sipërfaqet e mbjella, nga rritja e rendimentit dhe nga shtimi i serrave. Ecuria e prodhimit të brendshëm bujqësor është një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e normës së inflacionit duke qenë se prodhimet bujqësore zënë rreth 43 për qind të shportës së mallrave të konsumit.


• **Indeksi i çmimeve të prodhimit.**

Çmimet e prodhimit gjatë tremujorit të dytë të vitit 2005 kanë njohur ritme më të ngadalta rritjeje, të cilat nuk janë përcjellë në çmimet e konsumit. Në krahasim me tremujorin e dytë të vitit të kaluar, çmimet e prodhimit janë rritur me 4.0 për qind, ndërsa ndaj tremujorit paraardhës janë rritur me 1.2 për qind. Rritja është vënë re në të gjithë sektorët e prodhimit¹¹.

• **Çmimi i naftës.**

Rritja e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar është një nga shqetësimet kryesore për ekonominë importuese, në të cilat përfshihet dhe vendi ynë. Megjithatë, pasqyrimi i veprimit të drejtpërdrejtë, në rritjen e inflacionit apo në efektin indirekt, duke rritur kostot e mallrave dhe shërbimeve që e përdorin këtë input - ka qenë më pak i ndjeshëm në vendin tonë. Përkundrazi, peshat e vogël që zë ky produkt¹² në shportën e konsumit, si dhe mbiçmimi i lekut ndaj dollarit kanë penguar transmetimin e plotë të rritjes së çmimit të këtij produkti në tregun vendas. Gjithsesi, së bashku me situatën e rënduar energjitike, ai mbetet një faktor i cili është vazhdimisht në vëmendjen e politikës monetare.

Grafik 17. Ndryshimet vjetore të çmimeve të mallrave bujqësorë, ushqimorë dhe inflacionit total.



⁹ Burimi: Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Statistikor Kombëtar i Greqisë; faqja e internetit: <http://www.statistics.gr>

¹⁰ Burimi: ISTAT; faqja e internetit <http://www.istat.it>


¹¹ Indeksi i çmimeve të industrisë nxjerrëse është rritur me 4.8 për qind, industria përpunuese me 3.7 për qind si dhe prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit me 7.4 për qind.

¹² Njëngrupi "Shërbime ndaj mjeteve personale të transportit", ku përfshihet dhe çmimi i naftës ka një peshë prej 1.6 për qind në shportën e IÇK-së.

• **Papunësia dhe pagat.**

Situata e qëndrueshme në tregun e punës por dhe rritja modeste e pagave në sektorin shtetëror nuk kanë përçuar presione inflacioniste në ekonomi. Tregu i punës, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2005, nuk ka pësuar ndryshime të rëndësishme.

Norma e papunësisë ka mbetur e pandryshuar ndërkohë që paga mesatare në sektorin shtetëror u rrit me 2 për qind krahasuar me tremujorin e parë të vitit¹³. Paga minimale dhe pagesa e papunësisë për të papunët mbeti e pandryshuar.




III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

III.1 POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË


Zhvillimet makroekonomike dhe pritshmëritë për normën e inflacionit kanë kushtëzuar ruajtjen e normës bazë të interesit të pandryshuar, gjatë tremujorit të tretë. Megjithatë, kushtet monetare kanë qenë nën ndikimin e faktorëve të jashtëm, efekti i të cilëve ka çuar në devijimin e treguesve monetarë nga ecuria e parashikuar. Duke vlerësuar se situata monetare dhe faktorët e tjerë që ndikojnë në inflacion janë nën kontroll, Banka e Shqipërisë ka ruajtur të pandryshuar politikën monetare. Pas uljes së fundit të normës bazë të interesit në muajin mars, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare neutrale, duke përdorur instrumentet operacionale të saj për administrimin e likuiditetit dhe për kufizimin e luhatjeve afatshkurtra të normave të interesit në tregje.

Rritja tej parashikimit e parasë cash në qarkullim dhe përqëndrimi i huamarrjes së brendshme të qeverisë, janë shoqëruar me përkeqësimin e gjendjes së likuiditetit të sistemit. Gjithashtu, si pasojë e ngushtimit të diferencës së normave të interesit gjatë këtij viti, prurjet valuore të emigrantëve kanë gjetur rrugën në sistemin bankar, kryesisht në formën e depozitave në valutë në bankat tregtare. Banka e Shqipërisë ka qenë aktive në tregjet e parasë duke përdorur si instrumentet afatshkurtra ashtu edhe ato



¹³ Rritja e pagave erdhi si rrjedhojë e vendimit të Këshillit të Ministrave për rritjen e pagës në disa sektorë në sistemin e shëndetësisë dhe të arsimit.

afatgjata për ruajtjen e ekuilibrit të kushteve monetare. Gjatë muajit korrik, Banka e Shqipërisë ndryshoi kahun e operacioneve monetare me qëllim plotësimin e nevojave afatshkurtra të sistemit për likuiditet, nëpërmjet kryerjes së repove të anasjellta. Paralelisht me të, financimi nga ana e Bankës së Shqipërisë i deficitit buxhetor nëpërmjet kredive direkte afatshkurtra për qeverinë, ka shmangur volatilitetin e normave të interesit të bonove të thesarit dhe njëkohësisht ka kufizuar rritjen e tyre. Këta faktorë kanë çuar në shkeljen e objektivit të mjeteve të brendshme neto gjatë tremujorit të tretë.



Sasia mesatare e likuiditetit të injektuar në sistem gjatë tremujorit të tretë është luhatur rreth nivelit 1.5 miliardë lekë. Mungesa e vazhdueshme e likuiditetit në sistem dhe tendenca në rritje e normave të interesave të bonove të thesarit të të gjitha maturiteteve, kushtëzuan ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë me anë të instrumenteve afatgjata të saj. Në gjysmën e dytë të muajit shtator (në fund të tremujorit), Banka e Shqipërisë injektoi 3.5 miliardë lekë nëpërmjet blerjes me të drejta të plota të bonove të thesarit me partnerë bankat e nivelit të dytë.

Mungesa e presioneve mbiçmuese të lekut gjatë muajve të verës, solli nevojën e rishikimit të pozicionimit të parashikuar të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor. Blerjet në tregun valutor, që karakterizojnë fundin e verës, kanë qenë të kufizuara gjatë këtij viti. Blerjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor kanë shtuar ofertën e parasë në lekë në masën 3 miliardë lekë, dhe kanë përmirësuar pjesërisht likuiditetin e sistemit.

Në këto kushte, u siguria një qetësim i situatës së likuiditetit dhe u zbutën presionet për rritje të interesave të bonove të thesarit. Aktualisht, sasia e likuiditetit të injektuar në sistem me anë të repove të anasjellta është 1 miliard lekë.

Në kushtet e minimizimit të presioneve ndaj normave të interesave të bonove dhe të rrezikut që shoqëron mungesa e likuiditetit në sistem, ecuria e disa treguesve monetarë ka rezultuar tej parashikimeve të programit monetar. Treguesi i mjeteve të brendshme neto (MBN) të Bankës së Shqipërisë ka tejkalluar nivelin objektiv prej 59 miliardë lekësh, me rreth 15.2 miliardë lekë, ndërsa niveli i rezervave ndërkombëtare neto (RNN) në fund të muajit shtator, është 51.1 milionë usd nën nivelin objektiv të Bankës së Shqipërisë.

Gjithsesi, tejkalimi i parashikimit të të dy treguesve në total (me kahe të kundërta) zbut ndikimet potenciale në treguesit e tjerë makroekonomikë dhe veçanërisht, në atë të inflacionit.

Tabelë 15. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.

	Dhjetër '04	Mars '05	Qershor '05	Korrik '05	Gusht '05	Shtator '05*
Rezervat Ndërkombëtare Neto (miliona dollarë)						
Objektiv	942	1,073	1,097	1117	1149	1,178.7
Aktuale	1,105	1,107	1,098	1105	1109	1127.5
Diferenca	163	35	11	-12	-45	-51.1
Mjetet e Brendshme Neto (miliardë lekë)						
Objektiv	79	61	60	60	59	59.0
Aktuale	61	50	64	65	66	74.1
Diferenca	-18	-8	4	5	7	15.2
Kredita e Brendshme Neto për Qeverinë (miliardë lekë)						
Objektiv	286	292	298	299	307.0	
Aktuale	285	288	294	298	299.2	
Diferenca	-1	-4	-4	-1	-1.8	


* Të dhëna operative.

III.2 ECURIA E AGREGATËVE MONETARË

Tremujori i tretë i vitit është shoqëruar me ngadalësimin e ndjeshëm të ritmit të rritjes së ofertës monetare, përkundrajt rritjes së shpejtë të saj në gjysmën e parë të vitit. Norma e rritjes vjetore të agregatit M3 në muajin gusht, zbriti në 15.4 për qind, nga 18.3 për qind që ishte në fund të muajit qershor. Ngadalësimi i ritmit të ofertës monetare është reflektuar kryesisht në përbërësin në lekë të saj, agregatin M2, kërkesa për të cilin është reduktuar si rezultat i rënies së normave të interesit të depozitave në lekë.

Nga ana tjetër, efekti më i lartë i mbiçmimit vjetor të lekut ka ndikuar negativisht rritjen e depozitave në valutë, e cila ndonëse në nivele mjaft të larta, ka qenë nën rritjen reale të tyre. Nën ndikimin e normave të ulëta të interesit në lekë dhe të rritjes sezonale të flukseve nga remitancat, struktura valutore e ofertës monetare është zhvendosur drejt depozitave në valutë, ndërkohë që struktura kohore ka rezultuar relativisht e qëndrueshme.

Depozitat në valutë kanë qenë treguesi monetar me rritjen më të shpejtë gjatë periudhës korrik – gusht, duke shënuar një rritje me 14.1 miliardë lekësh ose 10.4 për qind. Rritja vjetore prej 30.5 për qind e tyre në muajin gusht, përbën nivelin më të lartë të rritjes vjetore të këtij treguesi në tre vitet e fundit. Efekti vjetor i mbiçmimit të kursit të këmbimit ka zbehur tendencën rritëse të normave vjetore të depozitave në valutë. E vlerësuar me kurse këmbimi fikse, rritja vjetore reale e depozitave valutore në muajin gusht është rreth 33.6 për qind,





kundrejt 29.0 për qind që ishte në muajin qershor.

Rritja e depozitave në valutë gjatë periudhës korrik – gusht është mbështetur kryesisht në rritjen e lartë të depozitave me afat, të cilat kanë përbërë rreth 71 për qind të rritjes së depozitave totale në valutë. Krahas forcimit të flukseve valutore në muajt e verës, ecuria pozitive e depozitave në valutë është favorizuar edhe nga reduktimi i spread-it të normave të interesit, lekë - valutë, gjë që ka rritur atraktivitetin e tyre në raport me instrumentet e kursimit në lekë. Rritja më e shpejtë e depozitave në valutë në krahasim me treguesit e tjerë monetarë, është reflektuar në rritjen e peshës së tyre në ofertën e parasë. Në fund të muajit gusht, raporti i depozitave në valutë ndaj agregatit M3 arriti në nivelin maksimal historik prej 26.8 për qind, duke shënuar një rritje prej 1.7 pikësh përqindjeje nga niveli i muajit qershor.

Depozitat në lekë kanë kontribuar negativisht në rritjen e ofertës monetare gjatë periudhës korrik – gusht, duke shënuar një rënie prej 1 miliard lekësh ose rreth 0.4 për qind. Ritmi vjetor i rritjes së depozitave në lekë shënoi gjithashtu, rënie të ndjeshme, duke zbritur në 11.5 për qind, nga 14.7 për qind që ishte në muajin qershor. Kjo ecuri ka reflektuar uljen e konsiderueshme të depozitave në lekë të individëve me 1.5 miliardë lekë, ndërkohë që depozitat në lekë të sektorëve të tjerë kanë patur një ecuri normale. Tërheqja e depozitave në lekë nga ana e individëve ka ardhur si pasojë e uljes së menjëhershme të normave të interesit nga një pjesë e bankave të sistemit. Fluksi i depozitave të tërhequra nga sistemi bankar vlerësohet të ketë lëvizur pjesërisht në drejtim të investimeve në bono thesari¹⁴ dhe pjesërisht në depozita në valutë.

Struktura e depozitave në lekë sipas afateve ka njohur rritjen e ndjeshme të peshës së depozitave pa afat. Gjatë periudhës korrik – gusht depozitat pa afat në lekë kanë shënuar një rritje prej 19.0 miliardë lekësh, kundrejt rënies prej 20.0 miliardë lekësh të depozitave me afat në lekë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i ndryshimeve në klasifikimin e depozitave në lekë nga ana e Bankës Raiffeisen¹⁵. Rritja e depozitave pa afat në lekë është reflektuar në rritjen e ndjeshme të agregatit M1. Norma e



¹⁴ Portofoli i bonove të thesarit të individëve në muajt korrik – gusht është rritur me rreth 1 miliard lekë ose dy herë më shumë se rritja e tij në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

rritjes vjetore të këtij treguesi për periudhën korrik – gusht është rritur nga 25.8 për qind në 30.1 për qind. Ulja e normave të interesit të depozitave në lekë nuk ka ndikuar ndjeshëm në ekuilibrin e likuiditetit të ofertës monetare. Rritja me 4.7 miliardë lekë (3.4 për qind) e parasë jashtë bankave në periudhën korrik – gusht, është në përputhje me ecurinë sezonale të këtij treguesi, në përgjigje të nevojave në rritje të ekonomisë për mjete monetare likuide. Pas rritjes së ndjeshme të saj në muajin qershor, norma e rritjes vjetore të parasë jashtë bankave i është kthyer niveleve normale, duke zbritur në 9.0 për qind në muajin gusht. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3 në muajin gusht rezultoi në 25.1 për qind, duke shënuar një rritje me 0.6 pikë përqindjeje që nga fillimi i efektit sezonal në fund të muajit maj. Kjo përbën një rritje më të ulët krahasuar me rritjen e këtij raporti në të njëjtën periudhë të viteve të kaluara, çka tregon për vazhdimin me të njëjtat ritme të kthimit të parasë në sistem, pavarësisht normave të ulëta të interesit.

Tabelë 16. Ecuria e treguesve monetarë në korrik-gusht (në miliardë lekë).

	Gusht	Ndeshimi 2-mujar		Ndeshimi vjetor	
	2005	Absolut	Përqindje	Absolut	Përqindje
Fara jashtë bankave	140.5	4.7	3.4	11.6	9.0
Depozita totale	419.1	18.1	3.2	62.9	17.7
· në lekë	269.0	-1.0	-0.4	27.8	11.5
· në valutë	150.1	14.1	10.4	35.1	30.5
Depozita pa afat	113.5	23.0	25.4	42.7	60.3
· në lekë	59.9	18.9	46.0	34.8	138.7
· në valutë	53.6	4.1	8.3	7.9	17.3
Depozita me afat	305.7	-10.0	-3.1	20.2	7.1
· në lekë	209.1	-20.0	-6.7	-7.0	-3.2
· në valutë	96.5	10.0	11.6	27.2	39.3
M1	200.4	23.5	13.3	46.4	30.1
M2	409.3	3.7	0.9	38.4	10.6
M3	559.6	17.8	3.3	74.5	15.4
Baza monetare	183.9	2.4	1.9	13.5	7.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e mjeteve valutore neto të sistemit bankar në muajin gusht paraqitet e kënaqshme, me një rritje prej 112.7 milionë usd krahasuar me muajin qershor. Duke përjashtuar efektin e kursit të këmbimit¹⁶, rritja e këtyre mjeteve është 106.1 milionë usd. Kjo periudhë ka njohur kontributin më të ulët të këtyre mjeteve në rritjen vjetore të ofertës monetare që nga fillimi i vitit, duke arritur në 14 për qind në muajin gusht. Ulja e këtij kontributi shpjegohet pjesërisht nga ulja e ritmit të rritjes vjetore të mjeteve valutore neto në lekë. Pjesën më të madhe të kontributit në rritjen vjetore të ofertës monetare e ka dhënë rritja vjetore e mjeteve të brendshme neto gjatë tremujorit të tretë.

Zakonisht periudha korrik – gusht njih rritje të depozitave në valutë por ky vit njohu nivele më të larta rritjeje se një vit më parë. Kjo ecuri e depozitave në valutë, e ndikuar nga flukset hyrëse të valutës si dhe nga rënia e normave të interesave në lekë, ka krijuar

¹⁵ Politika e mosrinovimit të depozitave me afat në lekë të klientëve individë nga Banka Raiffeisen në përfundim të afatit të maturimit, ka shkaktuar riklasifikimin e tyre si depozita pa afat. Ndikimi i këtij riklasifikimi për muajt korrik dhe gusht është rreth 18.2 miliardë lekë.

¹⁶ Mjetet valutore neto të sistemit me kurs këmbimi euro/usd fiks.

hapësira për rritjen e mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë. Gjithashtu, dhe ulja e detyrimeve valutore ka ndikuar në një nivel më të lartë të mjeteve valutore neto për këtë periudhë. Rritja e mjeteve valutore të neto të bankave tregtare për këtë periudhë llogaritet rreth 98.1 milionë usd. E llogaritur me kursin fik, rritja e këtyre mjeteve është 97.1 milionë usd.

Rritja e rezervës valutore neto të Bankës së Shqipërisë për periudhën korrik – gusht, rezulton 14.6 milionë usd. Ky rezultat vjen nga rritja e disbursimeve të kredive të huaja (FMN, IDA). E llogaritur me kurs fik¹⁷, rezerva valutore neto e Bankës së Shqipërisë është rritur me 9.1 milionë usd.


III.3.2 Kërkesa e qeverisë për mjete monetare

Deficiti buxhetor për periudhën korrik – gusht ka patur një rritje të konsiderueshme duke kapur nivelin 13.5 miliardë lekë. Gjatë kësaj periudhe, deficiti u rrit me 6.7 miliardë lekë, rreth 2.2 miliardë lekë më shumë se rritja e këtij deficiti në të njëjtën periudhë vitin që shkoi.

Përballimi i deficitit fiskal është mundësuar nëpërmjet huamarrjes së re me rreth 4.4 miliardë lekë dhe përdorimit të fondeve të depozitës së qeverisë me 2.3 miliardë lekë. Banka e Shqipërisë ka financuar me 2.0 miliardë lekë deficitin buxhetor, për të shmangur luhatjet e normave të interesit në tregun ndërbankar dhe në atë të bonove të thesarit. Ky financim është kryer në formën e kredisë direkte afatshkurtër. Pjesa tjetër e financimit të brendshëm është siguruar nga emetimi i obligacioneve qeveritare dy - dhe trevjeçare. Emetimi gjatë periudhës korrik - gusht ishte 5 miliardë lekë obligacione dyvjeçare dhe rreth 2 miliardë lekë obligacione trevjeçare.


Rritja e huamarrjes së brendshme prej 9 miliardë lekësh ka kompensuar uljen prej 4.6 miliardë lekësh të nivelit të bonove të thesarit, të blera në tregun primar. Portofoli i bonove të thesarit të bankave të nivelit të dytë është ulur me 4.1 miliardë lekë gjatë muajve korrik

Grafik 24. Kontributi i rritjes së mjeteve valutore neto në rritjen vjetore të M3.



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 25. Niveli i mjeteve valutore neto të abstrimit bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

¹⁷ Diferenca vjen nga mbiçmimi i euros kundrejt dollarit me 1.4 për qind për periudhën korrik - gusht, që nënkupton një vlerë më të lartë të investimeve në euro të shprehura në usd.

-gusht. Një ulje prej 0.3 miliardë lekësh është vërejtur dhe në portofolin e institucioneve. Nga ana tjetër, individët kanë rritur portofolet e tyre të bonove të thesarit me 0.9 miliardë lekë. Banka e Shqipërisë pothuajse nuk ka patur lëvizje në portofolin e saj gjatë muajve korrik-gusht, por e ka rritur atë me 3.5 miliardë lekë gjatë muajit shtator, si pasojë e veprimeve në tregun sekondar.



III.3.3 Kredia për ekonominë nga sistemi bankar

Viti 2005 është karakterizuar nga zhvillime pozitive të kredisë për ekonominë. Teprica e kredisë është rritur me 31 miliardë lekë deri në muajin gusht; rritje kjo rreth 60 për qind më e lartë se rritja e tepricës së kredisë për gjithë vitin 2004. Aktiviteti i vullshëm i kreditimit ka sjellë rritjen e peshës që zë kredia për ekonominë ndaj M3, duke arritur vlerën 18 për qind në fund të muajit gusht. Gjithashtu, raporti i kredisë ndaj PBB-së në vlerën 11.8 për qind ka shënuar rritje të dukshme, duke u reflektuar në përmirësimin e të gjithë treguesve që lidhen me kredinë.


Tabelë 17. Ecuria e disa treguesve kryesorë të kredisë.

	2002	2003	2004	2005			
				T1	T2	Korrik	Gusht
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	416.7	448.4	507.2	521.6	541.8	545.3	559.6
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	70.8	71.5	68.9	68.3	69.9	70.4	69.2
Kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	61.5	60.2	55.1	53.4	52.2	52.4	51.1
Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	9.3	11.3	13.8	15.2	17.7	17.9	18.0
Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve)	11.5	13.7	16.9	17.7	20.8	21.1	21.5
Kredi për ekonominë (% ndaj PBB)	5.7	6.8	9.0	10.0	11.2	11.4	11.8
Depozita gjithsej (% ndaj PBB)	42.2	43.4	47.2	48.6	47.4	47.5	48.9
Raporti kredi/depozita (në %)	13.5	15.7	19.0	20.3	23.6	24	24.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja e tepricës së kredisë gjatë muajve korrik-gusht është rreth 5 miliardë lekë, duke pasqyruar një rënie të ritmeve të rritjes së kredisë krahasuar me pjesën e parë të vitit 2005. Kjo rënie ka ardhur pjesërisht si pasojë e faktorëve sezonalë dhe pjesërisht si pasojë e rritjes së pazakontë të kredisë për muajin qershor. Në veçanti, ngadalësimi i ritmeve të rritjes së tepricës së kredisë është pasojë e rritjes së përkohshme që pësoi kredia afatshkurtër në muajin qershor. Ky fakt mbështetet edhe nga niveli i kredisë së re të akorduar këto muaj, e cila ka qenë në nivele pothuajse të njëjta me periudhat e mëparshme të vitit. Gjithashtu, mbiçmimi e lekut ndaj euros dhe usd ka sjellë rënie të vlerës së kredisë në valutë me 0.8 miliardë lekë, duke ulur më tej ritmin e rritjes¹⁸.

Kredia në lekë shënoi një rritje vjetore prej 135 për qind në fund të muajit gusht. Kredia në lekë po njih një rritje relativisht më të mirë krahasuar me vitet e tjera, duke pasqyruar një angazhim më të madh të bankave drejt dhënies së kredisë në monedhën vendase. Gjithsesi, rritjet mujore të kësaj kredie kanë pasqyruar një rënie të ndjeshme krahasuar me tremujorin e dytë. Ritmet e larta të rritjes së kredisë në lekë kanë sjellë edhe rritjen e peshës së saj në kredinë totale.



Kredia për individët vazhdon të pasqyrojë të njëjtat ritme rritjeje si edhe në tremujorët e parë të vitit 2005. Shtysën më të madhe kjo kredi e merr nga kredia në lekë për individët, ritmi vjetor i rritjes së saj është rreth 3 herë më i lartë se sa ajo e vitit të kaluar.

Tabelë 18. Tregues të tepicës së kredisë ndaj totalit (në përqindje).

	2002	2003	2004		2005			
			T-3	T-4	T1	T2	Korrik	Gusht
Tepicën e kredisë (në mil. lekë)	38.7	50.7	61.0	70.0	79.9	95.9	97.7	100.97
Kred. i afatshkurtër	53.8	46.0	33.9	34.0	34.1	33.7	34.4	32.8
Kred. i afatmesëm	30.1	33.3	37.2	36.0	34.5	33.1	31.6	31.7
Kred. i afatgjatë	16.1	20.7	28.9	30.0	31.4	33.1	33.8	35.1
Kred. i për individët	18.3	24.5	30.8	30.6	31.0	30.8	31.4	32.4
Kred. i për sektorin privat	81.7	75.5	69.2	69.4	69.0	69.2	68.6	68.0
Lekë	21.3	19.6	17	20.0	20.0	22.9	23.2	23.4
Valutë	73.7	80.4	83	80.0	80.0	77.1	74.9	76.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë muajve korrik dhe gusht janë akorduar gjithsej rreth 20.7 miliardë lekë kredi e re. Në terma mujorë, kredia e re është pothuajse në të njëjtin nivel me muajt e tjerë të vitit dhe rreth 70 për qind më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rreth 50 për qind e kredisë së re të akorduar në këtë muaj ka qenë kredi afatshkurtër. 29 për qind e kësaj kredie është akorduar në lekë. Kredia për individët zë vetëm 25 për qind të totalit të kredisë së akorduar. Krahasuar me tremujorin paraardhës është ruajtur e njëjta strukturë e kredisë së akorduar si për monedhën ashtu edhe për afatin e maturimit.

¹⁸ Nënçmimi i lekut ndaj dollarit ndikoi në rritjen e tepicës së kredisë me rreth 0.8 miliardë lekë gjatë tremujorit paraardhës.

Tabelë 19. Tregues të kredisë së re ndaj totalit (në përqindje).

	2002	2003	2004		2005			
			Janar - Gusht	Janar - dhjetor	T-1	T2	Gusht	Janar - Gusht
Kredite re (në mlj lekë)	62.6	92.6	66.6	99.7	21.6	32.6	10.6	73.4
Kredi afan shkurtër	44.7	63.1	64.7	62.5	54.1	47.1	49.0	49.3
Kredi afan mesme	13	22.3	22.0	22.5	21.2	31.0	33.9	29.2
Kredi afan gjatë	4.8	7.4	13.3	14.9	24.7	21.9	17.1	21.5
Lekë	20.8	30.8	31.3	32.6	30.4	32.8	26.0	30.9
Valutë	41.8	61.8	68.7	67.4	69.6	67.2	74.0	69.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Muajt korrik dhe gusht nuk kanë shënuar ndryshime të peshës së kredisë sipas sektorëve, krahasuar me dy tremujorët paraardhës. Në fund të muajit gusht, sektori i tregtisë vazhdon të përbëjë pjesën kryesore të alokimit të kredisë, duke zënë 19 për qind të totalit. Ndërkohë që sektori i industrisë përpunuese ka pasqyruar një rënie të pozicioneve të tij.

Tabelë 20. Ecuria e treguesve të tepricës së kredisë sipas sektorëve në përqindje ndaj totalit.

	2002	2003	2004	2005			
				T1	T2	Korrik	Gusht
Bujësi, gjetha dhe stivkulturura	0.6	1	1.5	1.5	1.5	1.5	1.4
Industria përpunuese	17	17	17.1	16.7	15.6	15.1	15.1
Ndërrimi	8.6	10	9.8	11.2	11.2	11.2	11.0
Tregtia, riparimi i automobilove dhe artikujve shtëpiakë	40.4	34	23.3	20.6	19.1	19.1	19.0
Hotelle dhe restorante	6	6	8.3	5.2	4.7	4.7	4.4
Rosuritë e pohundshme	9.1	13	9.8	14.7	13.5	13.4	13.0
Të hera	18.1	19	30.2	30.1	34.3	35.1	36.1
Totali	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.


III.4 TREGJET FINANCIARE, NORMAT E INTERESIT DHE KURSI I KËMBIMIT

III.4.1 Ecuria e likuiditetit

Rritja e kredisë së brendshme e shoqëruar me ngadalësimin e fluksit të depozitave në banka gjatë tremujorit të tretë të vitit, është reflektuar në rënieën e nivelit të likuiditetit të tepërt të sistemit bankar, duke shënuar në disa raste dhe vlera negative të tij. Mesatarisht, niveli ditë i likuiditetit në këtë periudhë rezultoi 1.07 miliardë lekë, ndërkohë që në tremujorin e kaluar sistemi bankar llogariste mesatarisht 7.05 miliardë lekë likuiditet të tepërt në ditë. Një vit më parë, ky tregues shënonte vlerën 5.49 miliardë lekë ose 4.43 miliardë lekë më shumë se në tremujorin e tretë të këtij viti.

Fillimi i muajit korrik vijoi me organizimin javor të ankandëve të repos për tërheqjen e likuiditetit. Në vazhdim, për plotësimin e nevojave për likuiditet janë organizuar kryesisht ankande të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim shtatëditor, për vlerën mesatare 1.44 miliardë lekë.

Krahas tyre, me qëllim injektimin e përhershëm të likuiditetit dhe rregullimin e strukturës së tij në treg, janë organizuar transaksione për blerjen me të drejta të plota të letrave me vlerë të qeverisë. Këto operacione, si dhe rritja e depozitave në lekë gjatë muajit shtator¹⁹ kanë ndikuar në përmirësimin e situatës së likuiditetit, dhe fillimi i muajit tetor ka shënuar vlera pozitive për këtë tregues.



Niveli mesatar i depozitës njëditore në tremujorin e tretë rezulton 0.72 miliardë lekë ose 0.26 miliardë lekë më shumë se në tremujorin e kaluar dhe 0.48 miliardë lekë më pak se një vit më parë. Kredia njëditore është përdorur shumë rrallë (me një mesatare prej 0.04 miliardë lekësh) dhe nevojat ditore për likuiditet janë plotësuar kryesisht në tregun ndërbankar.

Vëllimi mesatar ditor i totalit të huadhënies në tregun ndërbankar, në tremujorin e tretë rezulton 1.56 miliardë lekë, nga 1.35 miliardë lekë në tremujorin e kaluar dhe 0.55 miliardë lekë një vit më parë. Vëllimi mesatar i huadhënies midis bankave qëndron mbi nivelin mesatar të likuiditetit për periudhën, duke qenë tregues i shpërndarjes josismetrike të tij.

Huadhënia, ka patur kryesisht formën e transaksioneve njëditore dhe shtatëditore. Vëllimi mesatar i transaksioneve njëditore është rritur në 0.84 miliardë lekë nga 0.75 miliardë lekë në tremujorin e kaluar dhe 0.39 miliardë lekë vitin e kaluar.

III.4.2 Ecuria e normave të interesit

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2005, politika monetare e zbatuar nga Banka e Shqipërisë ka qenë neutrale. Norma bazë e interesit ka qëndruar në nivelet më të ulëta historike. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe, janë vënë re presione të rritjes së normave të interesit si në treg ndërbankar, në treg primar, në tregun e depozitave në lekë, në tregun e obligacioneve, në tregun e kredive për afatet nën 1 vit etj..


Faktori kryesor që ka ndikuar në rritjen e interesave në tregje ka qenë ndryshimi i situatës së likuiditetit të bankave. Në tregun primar të bonove të thesarit është vënë re rënie e likuiditetit të ofruar nga bankat, gjë që ka sjellë dhe rritje të *yield*-it të bonove të thesarit. Në disa raste, kërkesa e qeverisë për financim me bono thesari ka mbetur e paplotësuar.

¹⁹ Të dhëna operative.

Tabelë 21. Ndryshimi tremujor i interesave në tregje (në pikë përqindje)

	Shtatori 2005	3 muaji I	3 muaji II	3 muaji III
Norma bazë e interesit	5.00	-0.25	0.00	0.00
Tregu ndërbankar				
Interesi i tregut ndërbankar 1-ditor	4.37	-0.24	-0.74	+2.10
Interesi i tregut ndërbankar 7-ditor	4.50	-0.33	-0.24	-0.38
Tregu primar				
yield-i i bono thesarit 3 - mujore	6.73	-0.66	-0.18	+1.67
yield-i i bono thesarit 6 - mujore	8.64	-0.71	-0.11	+2.25
yield-i i bono thesarit 12 - mujore	9.13	-0.96	-0.35	+2.34
Tregu i obligacioneve				
yield-i i obligacioneve 2 - vjeçore	9.70	-1.15	-0.25	+2.10

Burimi: Banka e Shqipërisë.



Në treg ndërbankar, interesat e huamarrjeve njëditore, u ritën, pas gati 4 vjet rënieje të vazhdueshme të tyre. Këtu, ndër të tjera kanë ndikuar rritja e kërkesës për likuiditete në treg dhe rritja e interesit të depozitave njëditore nga Banka e Shqipërisë²⁰. Përkundrazi, interesat e huamarrjeve 7- ditore, kanë patur tendencë rënëse. Këtu, ka ndikuar kryesisht, ulja e interesit të kredisë njëditore me 0.75 pikë përqindjeje²¹. Ngushtimi i korridorit të interesave të lehtësive mbështetëse, ka sjellë dhe ngushtimin e *spread*-it midis interesave një- dhe shtatëditorë në treg ndërbankar.

Në tregun primar, ka patur rritje të *yield*-it të bonove të thesarit, në të gjitha afatet, ku rritja më e madhe ka qenë në afatet 12- mujore.

Rritja e *yield*-it të bonove të thesarit ka ardhur si pasojë e reduktimit të kërkesës së bankave në tregun primar²² dhe e rritjes së huamarrjes së qeverisë në këtë treg. Duke qenë se ky volatilitet rrit pasigurinë në tregun e parasë dhe koston e borxhit të qeverisë, Banka e Shqipërisë ka synuar që me anë të injektimit të likuiditetit në sistemin bankar, nëpërmjet ankandeve të anasjellta repo²³, të zbusë presionet rritëse. Gjithashtu, ajo ka ofruar kredi direkte për qeverinë duke reduktuar veprimet spekuluese në treg.

Në tregun e depozitave dhe të kredive në lekë²⁴, ka patur rritje të interesave të depozitave në të gjitha afatet dhe rritje të interesave të kredive për afatet deri në një vit.

²⁰ Në korrik 2005, Banka e Shqipërisë vendosi që interesi i depozitës njëditore të qëndronte 1.75 pikë përqindjeje poshtë normës bazë të interesit, duke bërë që këta interesa të rriteshin me 1.25 pikë përqindjeje.

²¹ Në korrik 2005, Banka e Shqipërisë vendosi që interesi i kredisë njëditore të qëndronte 1.75 për qind, mbi normën bazë e interesit.

²² Kështu, gjatë tremujorit të tretë, kërkesa e qeverisë për likuiditete në treg primar, është plotësuar në masën 97 për qind nga 131 për qind që ishte në tremujorin e mëparshëm.

²³ Banka e Shqipërisë i ka përdorur të dy tipet e repove (me çmim fiks e me shumë çmime) në varësi të situatës.

²⁴ Në tabelë shih- tremujori III* gusht '05-qershor '05.

Tabelë 22. Ndryshimi tremujor i interesave (në pikë përqindjeje).

	Gusht 2005	3 muajt 2005	3 muajt II 2005	3 muajt III* gusht'05-qershor'05
Depozita në lekë				
1 - mujore	3.24	0.16	-0.46	+0.13
3 - mujore	3.13	-0.32	-1.08	+0.05
6 - mujore	3.90	-0.56	-1.08	+0.13
12 - mujore	4.42	-0.55	-1.55	+0.53
24 - mujore	6.91	-0.19	-2.78	+2.50
Kredit në lekë				
deri në 6 muaj	14.49	+3.02	-3.38	+3.87
6 - 12 muaj	13.02	-1.31	-0.90	+1.40
1-3 vjet	16.15	-1.87	-1.89	-0.51
+ 3 vjet	12.07	-0.51	-0.02	-0.29

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja e interesave të depozitave në lekë, pritet që të rrisë interesimin e depozituesve, për vendosjen e kursimeve të tyre pranë bankave, gjë që do të sjellë rritjen e këtyre depozitave. Sipas të dhënave operative, efektet e kësaj rritjeje janë të pranishme në muajin shtator. Në muajin gusht 2005, interesat realë të depozitave me afat 12- muajor në lekë, arritën në 2.07 për qind, nga 0.96 për qind që ishin në fund të tremujorit të dytë dhe 3.53 për qind që ishin një vit më parë. Këtu kanë ndikuar luhatjet e inflacionit dhe ndryshimi i interesave nominalë. Bankat tashmë kanë filluar të ofrojnë dhe shërbimin e pranimit të depozitave deri në 3 vjet. Kjo do të mundësojë investimin e kursimeve të depozituesve, në afate më të gjata, gjë që pritet të sigurojë dhe një lidhje më të ngushtë midis interesave të këtyre depozitave me ata të kredive afatgjata dhe të obligacioneve qeveritare. Në tregun e kredive në lekë, interesat mesatarë të ponderuar kanë patur tendencë të rriten për kreditë me afat nën një vit dhe janë ulur për kreditë mbi një vit²⁵. Në rritjen e interesave afatshkurtër kanë ndikuar, rritja e *yield*-it të bonove të thesarit, pritshmëritë afatshkurtra dhe afatgjata për ecurinë e normave të interesit, ndryshimi i strukturës së kredidhënies, shkalla e rrezikut etj.. Në tregun e depozitave në valutë, sikurse dhe në tregun e depozitave në lekë ka patur rritje të interesave në të gjitha afatet, me përjashtim të interesave të depozitave 24-mujore në usd dhe të depozitave 6- dhe 12- mujore në euro.

Tabelë 23. Ndryshimi 3-mujor i interesave (në pikë përqindjeje).


	Gusht 2005	3 muajt I 2005	3 muajt II 2005	3 muajt III* gusht'05-qershor'05
Depozita në usd				
1 - mujore	1.83	0.22	0.04	0.09
3 - mujore	2.13	0.26	0.09	0.09
6 - mujore	2.31	0.22	0.13	0.08
12 - mujore	2.79	0.22	0.13	0.17
24 - mujore	3.15	0.37	0.14	-0.01
Depozita në euro				
Depozita 1-mujore	1.67	0.02	-0.01	0.01
Depozita 3-mujore	1.52	0.00	-0.01	0.08
Depozita 6-mujore	1.63	0.04	0.07	-0.06
Depozitave 12-mujore	1.91	-0.07	0.31	-0.30
Depozitave 24-mujore	3.06	0.75	-0.33	0.33

Burimi: Banka e Shqipërisë.

²⁵ Në tabelë shih- tremujori III* gusht '05-qershor '05.


Këtu ka ndikuar rritja disa herë e normës bazë të interesit nga Fed-i, brenda tremujorit të tretë; rritja e interesave libor e euribor në tregjet ndërkombëtare, rritja e konkurrencës në tregje etj..

Tregu i kredive në valutë është karakterizuar nga luhatjet e interesave nga njëri tremujor në tjetrin. Në muajin gusht 2005, interesat mesatarë të ponderuar të kredive në usd, arritën në 8.71 për qind nga 8.1 për qind që ishin në fund të tremujorit të dytë dhe interesat e kredive në euro arritën në 5.8 për qind, nga 5.63 për qind që ishin në fund të tremujorit të dytë. Megjithatë, duke i parë veçmas, sipas afateve, në tregun e kredive në usd dhe në euro, nuk kanë munguar rastet e rritjes dhe të uljes së këtyre interesave si rezultat i politikës së bankave, i shkallës së rrezikut sipas llojit të kredive, i ndryshimit të peshës së kredidhënësve, i konkurrencës etj..



III.4.3 Kursi i këmbimit

Tremujori i tretë i vitit 2005 shfaqti tendenca mbiçmuese të lekut në pjesën e parë të tij dhe më pas vazhdoi me nënçmim të lekut kundrejt monedhave kryesore. Mesatarisht gjatë këtij tremujori, leku është mbiçmuar në terma vjetorë me 1.5 për qind kundrejt dollarit dhe 1.7 për qind kundrejt euros. Efekti sezonal i muajve të verës është paraqitur i zbehtë këtë vit, duke rezultuar në rënie të ritmeve mbiçmuese të lekut, sidomos krahasuar me dy vite më parë. Frenimi i presioneve sezonale i detyrohet kryesisht reduktimit të diferencës së normave të interesit lekë-valutë.



Tabelë 24. Mesatarja e ndryshimit vjetor²⁶ të kursit të këmbimit të lekut në tremujorë.

	13/2003	13/2004	13/2005
Lekë / Usd	-13.10	-15.12	-1.56


Burimi: Banka e Shqipërisë.

²⁶ Shenja minus tregon mbiçmim të lekut kundrejt valutave të huaja.

Deri nga mesi i muajit gusht, leku kundrejt euros ka vazhduar të ecë në ritme të njëjta të mbiçmimit, të vëna re që në fillimin e vitit. Pas kësaj periudhe, leku është pozicionuar në kahun e nënçmimit. Kundrejt dollarit, megjithëse ka patur disa luhajtje, më shumë të bie në sy prirja nënçmuese e lekut që ka vazhduar dhe për muajin shtator. Kërkesa më e lartë për turizëm jashtë Shqipërisë, duket të ketvepruar në favor të rritjes së kërkesës për valutë të huaj. Gjithashtu, edhe situata para dhe paszgjedhore duket të ketë ndikuar sjelljen e publikut dhe vendimet e tij për mbajtjen e valutave.

Nga ana tjetër, ngushtimi i vazhdueshëm i diferencës së normave të interesit lekë

dhe valutë nuk përbën më një mbështetës për mbiçmimin e lekut, e shprehur kjo dhe në rritjen që depozitat në valutë kanë patur gjatë këtij tremujori. Në fund të muajit shtator nivelet e tregimit të lekut shënojnë 123.41 lek/euro dhe 102.6 lek/usd.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

NR. 83, DATË 01.11.2005

PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË DEPARTAMENTIT JURIDIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 43, shkronja "h" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" si dhe të rregullave "Mbi marrëdhëniet e punës të punonjësve në Bankën e Shqipërisë" miratuar me vendimin nr. 110, datë 24.12. 2003, neni 7 shkronja "a", me propozimin e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Juridik, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

V E N D O S I :

1. Të emërojë në funksionin e Drejtorit të Departamentit Juridik të Bankës së Shqipërisë z. Toni Gogu.
2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe i Komunikimit me publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
YLLI MEMISHA

KRYETARI
ARDIAN FULLANI

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 1, Shkurt 2005

1. Vendim nr.01, datë 26.01.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë mbi zhvillimet ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2004".
2. Vendim nr.02, datë 26.01.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri".
3. Vendim nr.03, datë 26.01.2005 "Për një ndryshim në rregulloren "Për dhënien e licencës, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë".
4. Vendim nr.04, datë 26.01.2005 "Për caktimin e afateve të plotësimit të kërkesës për rritjen e kapitalit të kërkuar të bankave".
5. Vendim nr.08, datë 26.01.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun në Bankën e Shqipërisë".
6. Vendim nr.09, datë 26.01.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Logjistike të Bankës së Shqipërisë".
7. Vendim nr.10, datë 26.01.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Logjistike të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 2, Shkurt 2005

1. Vendim nr.11, datë 09.02.2005 "Për miratimin e dokumentit për misionin e mbikëqyrjes".
2. Vendim nr.12, datë 09.02.2005 "Për dhënien e miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, të bankës së propozuar "Union Bank" sh.a.".
3. Vendim nr.13, datë 09.02.2005 "Për miratimin e kontratës - tip për marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve të letrave me vlerë".
4. Vendim nr.14, datë 09.02.2005 "Për miratimin e rregullores për dhënien e kredive për strehimin dhe përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 3, Shkurt 2005

1. Vendim nr.15, datë 23.02.2005 "Për miratimin e Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2005".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 4, Prill 2005

1. Vendim nr.18, datë 09.03.2005 "Për miratimin e konfigurimeve të vizatimeve të monedhave përkujtimore, që do të shtypen për qëllime numizmatike, në vitin 2005".
2. Vendim nr.19, datë 09.03.2005 "Për mënyrën e vlerësimit të vlerave numizmatike pa kosto në Bankën e Shqipërisë".
3. Vendim nr.22, datë 09.03.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 5, Prill 2005

1. Vendim nr.24, datë 30.03.2005 "Për uljen e përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes nga Banka e Shqipërisë".
2. Vendim nr.27, datë 30.03.2005 "Për shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, për vitin 2006".
3. Vendim nr.28, datë 30.03.2005 "Për miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 6, Maj 2005

1. Vendim nr. 30, datë 27.04.2005 "Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin mars të vitit 2005".
2. Vendim nr. 31, datë 27.04.2005 "Për një ndryshim në rregulloren për normat e mbikëqyrjes së subjekteve jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare".
3. Vendim nr. 32, datë 27.04.2005 "Për miratimin e sistemit raportues për subjektet jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare".
4. Vendim nr. 33, datë 27.04.2005 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 25, datë 01.04.2003 për miratimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003".
5. Vendim nr. 35, datë 27.04.2005 "Për miratimin e udhëzimit mbi procedurat dhe shpenzimet e daljes jashtë shtetit për shërbim, kualifikim etj., të punonjësve dhe të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 7, Maj 2005

1. Vendim nr. 36, datë 19.05.2005 "Për miratimin e udhëzimit mbi procedurat e shtypjes, rishtypjes dhe të emetimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike nga Banka e Shqipërisë".
2. Vendim nr. 38, datë 19.05.2005 "Për miratimin e rregullores mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore".
3. Vendim nr. 40, datë 19.05.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave në Bankën e Shqipërisë".
4. Vendim nr. 41, datë 19.05.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 8, Qershor 2005

1. Vendim nr. 42, datë 08.06.2005 "Për miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2005".
2. Vendim nr. 43, datë 08.06.2005 "Për miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim - kreditit dhe unioneve të tyre".
3. Vendim nr. 44, datë 08.06.2005 "Për miratimin e sistemit raportues për shoqëritë e kursim - kreditit dhe të unioneve të tyre".
4. Vendim nr. 45, datë 08.06.2005 "Për disa ndryshime në udhëzimin për kapitalin rregullator të Bankës së Shqipërisë".
5. Vendim nr. 46, datë 08.06.2005 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren për mjaftueshmërinë e kapitalit".
6. Vendim nr. 47, datë 13.06.2005 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Dardania sh.a. nga fondet për rindërtimin e Kosovës tek Fonds der Republik der Kosova, Gjermani".
7. Vendim nr. 48, datë 13.06.2005 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Dardania sh.a. nga Fonds der Republik der Kosova, Gjermani tek Francesco Mariano Mariano dhe Banca Popolare Pugliese (Banka Popullore Pulieze)".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 9, Qershor 2005

1. Vendim nr. 49, datë 29.06.2005 "Për miratimin e "Raportit të Politikës Monetare për muajin maj të vitit 2005".
2. Vendim nr. 51, datë 29.06.2005 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e

- sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)"".
3. Vendim nr. 52, datë 29.06.2005 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për funksionimin e sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH"".
 4. Vendim nr. 53, datë 29.06.2005 "Për "miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH"".
 5. Vendim nr. 54, datë 29.06.2005 "Për disa ndryshime në "Rregullat dhe procedurat e sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIPS"".
 6. Vendim nr. 55, datë 29.06.2005 "Për disa ndryshime në "Rregullat e brendshëm të funksionimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIPS.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 10, Korrik 2005

1. Vendim nr. 56, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Mbi transaksionet e shitbjeve me të drejta të plota"".
2. Vendim nr. 57, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për kredinë Lombard"".
3. Vendim nr.58, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për depozitën njëditore"".
4. Vendim nr. 59, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për kredinë njëditore"".
5. Vendim nr. 60, datë 13.07.2005 "Për vendosje komisioni në sportelet e Bankës së Shqipërisë për bonot e thesarit".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 11, Gusht 2005

1. Vendim nr.66, datë 28.07.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi zhvillimet ekonomike dhe monetare për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2005".
2. Vendim nr. 67, datë 28.07.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri".
3. Vendim nr.68, datë 28.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për mbikëqyrjen e konsoliduar".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 12, Shtator 2005

1. Vendim nr.70, datë 31.08.2005 "Për miratimin e raportit të Politikës Monetare për muajin korrik të vitit 2005".
2. Vendim nr. 71, datë 31.08.2005 "Për miratimin e udhëzimit "Mbi mënyrën e llogaritjes së "fiksit" të kursit të këmbimit të lekut, në Bankën e Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 13, Tetor 2005

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 77, datë 12.10.2005 "Për miratimin e raportit të Politikës Monetare për muajin gusht të vitit 2005".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 12.10.2005 "Për miratimin e përmbajtjes dhe konfigurimeve të vizatimeve të monedhës që do të shtypet për qëllime numizmatike në vitin 2006".

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558
www.bankofalbania.org
E-mail: public@bankofalbania.org
Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 320 kopje